

**Sistemi i Regjistrimit Pasurisë
Paluajtëshme (SRPP) i Shqipërisë**

Draft
Plani i Biznesit

2001 – 2004

Pergatitur nga ILIA KRISTO (PROFESOR, FAKULTETI I EKONOMISE)

Dhe Grupi i Punes per Planin e Biznesit, i perbere nga:

BEGE MUSTA (ZEVENDES KRYEREGJISTRUES, SRPP), MERITA QATO (DREJTORE JURIDIKE, SRPP), MARJANA HOXHA (DREJTORE E FINANCES, SRPP), SELIM CELA (PERGJEGJES I KONTROLLIT FINANCIAR, SRPP), ALTIN SPAHO (INXHINIER, SRPP),

Me ndihmen e Mark Marquardt, University i Wisconsin
John Manthorpe, ish-Kryeregjistruesi i Anglise
Dhe Helen Schutten, ish-Regjistruese e Racine County, Wisconsin

**Draft: Paraqitur Kryeregjistruesit
dhe
Grupit te Punes per Planin e Biznesit per Diskutim**

Shtator 2001

Sistemi i Rregjistrimit te Pasurise se Paluajtshme ne Shqiperi

Mbi Strukturen e Dokumentacionit te Agjensise

Shtator 2001

PERMBAJTJA

PARATHENIE	1
1. Statusi dhe funksionet	2
2. Qellimet dhe Objektivat	3
3. Standartet e Sherbimit Publik	4
4. Llogarite dhe Marredheniet me Qeverine	5
5. Planifikimi Financiar dhe Kontrolli	6
6. Personeli dhe Trajnimi	7
7. Marredheniet me me Institucione te tjera	7
8. Rishikimi i Sistemit te Dokumentave	7
9. Komponentët e Planit	7
A Regjistrimi i Tokave – Ligji dhe Procedurat	9
B Organizimi	10
C Personeli	12
D Trajnimet	14
E Volumi i Veprimeve	14
F Financimi dhe Shpenzimiet	15
G Të Ardhurat nga Tarifat	17
H Puna dhe Performanca	19
I Sherbimi ndaj Klientit	23
J Investimet	26
Akomodimi	
Pajisje dhe Shërbime	
K Teknologjia e Informacioni	

Agjensia Kombetare e Rregjistrimit te Pasurise se Paluajtshme (AKRPS)

Parathenie

Ne vitin 1993, Qeveria aprovoi Planin e Veprimit per Sistemin e rregjistrimit te Pasurise se Paluajtshme dhe Aktivitete e tjera te Tregut te Tokes. Nje nga hapat e para te kalimit drejt nje ekonomie te orientuar nga tregu ne Shqiperi, ka qene privatizimi ne shkalle te gjere i pasurise shteterore, duke bere kalimin e kesaj pasurie tek pronaret private. Privatizimi i pasurise se paluajtshme eshte bere nepermjet shume programeve krahas plotesimit te legjislacionit.

Programi i privatizimit i Qeverise filloi ne vitin 1992 dhe aty nga viti 1992 shumellojshmeria e programeve dhe numuri i madh i pronareve te rinj te ketyre pronave tejkaloi mjaft kapacitetin institucional egzistues per rregjistrimin e ketyre te drejtave te reja dhe transakcionet e mevoneshme me çfaqjen e tregut te tyre. U be e qarte se duhej te krijohej si kudo ne boten e zhvilluar, nje institucion i vetem shteteror ku te garantoheshin nepermjet rregjistrimit, tedrejtat e reja private te tokes dhe pasurise duke bere te mundur dhe nxitur kesisoj transferimin e sigurte dhe me kosto te ulet te te drejtes se tokes ne nje treg te zhvilluar te tokes.

Ne baze te Ligiit No 7843 te Korrikut 1994 “ Mbi Rregjistrimin e Pasurise se Paluajtshme”, u krijua nje institucion i ri. Tani nje pjese e konsiderueshme e pronave private jane ne proces rregjistrimi dhe programi per dhe programi per te bere rregjistrimin fillestar te pasurive ne Shqiperi vazhdon. Si rezualtat, besimi ne pronesine e tokes eshte rritur ne menyre te konsiderueshme dhe numuri i transakcioneve te tokes dhe hipotekimeve po shtohet shume.

Eshte i nevojshem reformimi me tej i sistemit te rregjistrimit ne menyre qe Institucioni te jete ne gjendje te perballoje sfidat me te cilat konfrontohet, nderkohe qe hipotekimet zhvillohen me tej dhe pergjegjesia rritet. Une klam kenaqesine te themeloj Sistemin e Ri te Rregjistrimit te Prones si “ *Agjensia Kombetare e Rregjistrimit te Pasurise se Paluajtshme*” (AKRPP) Agjensia do te kete liri administrative per te manaxhuar anen financiare ne menyre sa me sfektive por duke mbetur institucion shteteror dhe brenda kuadrit financiar shteteror. Ky dokument i Agjensise, pasqyron marreveshjen qe egziston midis Qeverise dhe Agjensise e cila do te punoje per te harmonizuar dhe bere publike synimet operacionale, financiare dhe te sherbimeve te konsumatorit.

Une e kam bindjen qe Kryeregjistruesi dhe stafi i tij jane ne gjendje te permiresojne sherbimet e rendesishme qe ata i ofrojne popullsisë, dhe biznesit dhe do te doja t’u uroja sukses ne realizimin e detyrave statutore qe permban ky dokument.

Ilir Meta

Kryetar i Keshillit te Ministrave

1. Statusi dhe Funkcionet

Titulli dhe Periudha e Krijimit

Sistemi i Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme në Shqipëri u krijua në vitin 1994. Kjo organizatë që njihet me emrin SRPP këtej e tutje do të njohet si AKRPP.

Autoriteti Ligjor

Ligji No 7843 i datës 13 Qershor 1994, “ Mbi Rregjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme” (i amenduar) i jep ARPP autoritetin për ta kryer këto funksione.

Funksionet Ligjore

Funksioni kryesor i Agjensisë është që të ruajë dhe të mbajë regjistrimin të saktë dhe të garantuar të tokës për interesat ligjore për token dhe pasurinë në Shqipëri. Ajo jep informacion për të gjithë ata që kanë nevojë për to, në lidhje me pronësinë edhe të drejtat e tjera që ekzistojnë për token. Ajo regjistron interesat të reja, të amenduara ose të anuluar kur ka transaksione.

Kryeregjistruesi

Ligji mbi rregjistrimin e pasurisë së paluajtshme i ngarkon përgjegjësinë për drejtimin e biznesit të rregjistrimit të tokës një zyrtari i cili caktohet nga Këshilli i Ministrave i njohur si Kryeregjistruesi.

Përgjegjësia e Shtetit

Këshilli i Ministrave ka përgjegjësi për Agjensinë dhe për caktimin e Kryeregjistruesit. Zëvendëskryeministri është përkrahës i drejtperdrejtë për Kryeregjistruesin. Zëvendëskryeministri do të përkrahë interesat e Agjensisë Brenda Këshillit të Ministrave vecanerisht për sa i përket anës financiare, legjislativitetit dhe politikës.

2. Qellimet dhe Objektivat

Qellimet kryesore te Agjensise jane:

- Te siguroje tituj te garantuar te tokes dhe pasurisene baze te Ligjit te Pasurise se paluajtshme.
- Te mbeshtese dhe zhvilloje nje sistem te sigurt te regjistrimit te tokes ne te gjithë Shqiperine, si baze e tregut te tokes, te pasurise dhe te hipotekave.
- Te siguroje nje informacion te sigurte dhe te perditesuar per token.
- Te arrije objektivat financiare dhe te tjera te vendosura nga K.M.
- Te operoje sipas rregullave shteterore aktuale per sherbimin publik.

Per te mbeshtetur keto qellime agjensia do te ndjeke keto objektiva strategjike:

- Te siguroje qe sherbimet e ofruara te jene sa me te shpejta dhe sa me te sakta dhe te perkojne me nevojat e zhvillimit te tregut te tokes dhe gjithë atyre qe u nevojiten keto sherbime
- Te beje perpjeklje per te vene taksa te niveleve me te ulta dukje mbuluar te gjithë shpenzimet vjetore duke perfshire mirembajtjen dhe ofrimin e nje sherbimi sa me cilesor te regjistrimit.
- Te siguroje qe zhvillimi dhe integrimi i regjistrimit kombetar te tokes te mirembahet sa kohe qe programi i regjistrimit fillestar te plotesohet.
- Te zhvilloje dhe te mbaje te azhornuar indeksin e hartes per te gjithë pasurite ne Shqiperi.
- Atje ku te jete e mundur, duke pase parasysh edhe lkushtet e mjedisit kombetar te furnizimit me energji te vazhdueshme elektrike, te zgjerohet perdorimi i kompiuterave per te zevendesuar rruget tradicionale te regjistrimit, te pranimit dhe te perditesimit.
- Te synoje sigurimin e kushteve te mira te punes per punonjesit vecanerisht per s ai perket akomodimit, lehtesive te zyres, si dhe duke e nxitur per nje nivel me te larte te moralit dhe motivimit

3. Standartet e Sherbimit Publik

- Te kerkoje te arrije standarte te larta te sherbimit, e klienteve, per te gjithë ata qe perdorin dhe kane te bejne me zyrat qendrore dhe rajonale te agjensise.
- Te siguroje qe informacioni qe u nevojitet klienteve dhe perdoruesve te sherbimit te agjensise te jete i qarte, te behet publik dhe te jete i disponushem ne te gjitha zyrat.
- Te siguroje qe klientet te marrin faturat perkatese per te gjithë pagesat, tarifat dhe taksat qe paguajne ne Zyrat e Regjistrimit te Agjensise.
- Te zhvilloje objektiva te performances per shpejtesine e kryerjes se sherbimit dhe perkujdesjen qe duhet te tregohet ne te gjithë zyrat.
- Te zhvilloje proceduren per te mbledhur ankesat nga klientet. Te shpalle njoftime ne vende publike qe spjegojne keto procedura.
- Te siguroje qe te gjithë ata qe kane interes per sherbimet qe ofrohen nga agjensia, vecanerisht perdoruesit institucionale por dhe ato publik, te keshillohen ne menyren me te pershtatshme per te terhequr mendimet e tyre per agjensine. KryeRegjistruesi duhet ta perdore kete informacion per zhvillim te metejshem te sherbimeve te agjensise.

4. Pergjegjesia dhe marredheniet me Shtetin

Keshilli i Ministrave

Keshilli i Ministrave mbasi konsultohet me KryeRegjistruesisin:

- Miraton propozimet qe permban bizneplani.
- Vendos dhe aprovon objektivat financiare dhe te performances te agjensise.
- Percakton nivelin e tarifave ne baze te rekomandimeve te kryeregjistruesisit dhe ne marreveshje me ministrine e financave.
- Monitoron arrijten e objektiveve.
- Emeron dhe aprovon pagen dhe kushtet e sherbimit te KryeRegjistruesisit.

Kryeregjistruesi

- Eshte pergjegje sper te gjitha ceshtjet qe me ligj i takojne atij.
- Pergjigjet para Keshillit te Ministrave per performances dhe per perdorimin eficient te burimeve dhe per zhvillimin strategjik, drejtimin dhe udheheqjen e agjensise.
- Do te prezantoje raport vjetor ne Keshillin e Ministrave qe do te pasqyrojne rezulteatet faktike kundrejt objektiveve, progresi ne zhvillimet e reja dhe te tregoje strategjine per te ardhmen. Raporti duhet te permbaje nje informacion agregat per vellimin vjetor te aplikimeve per tarifate e marra, per shpenzimet, per stafin e punesuar, per shpejtesine e sherbimit nga stafi dhe per ankesat e klienteve.
- Te mbaje marredhenie pune produktive me te tjeret ne qeveri si dhe me institucionet e tjera, subjektet profesionale, te cilet jane te angazhuar ne tregun e tokes me synimin e thjeshtimit dhe te permiresimit te vazhdueshem te procedurave te transferimit te informacionit per to.
- Te perpiqet te siguroje nivelin me te larte te besimit te publikut ne punen dhe sidomos ne paanshmerine dhe qendrimin e agjensise.
- Eshte pergjegjes per zhvillim e stafit te tij dhe te mireqenies se tij.

5. Planifikimi Financiar dhe Kontrolli

Rregullat ekzisutese

Sipas regullave ekzistuese financiare shpenzimet e agjensise perballohen pjeserisht nga buxheti vjetor i aprovuar nga qeveria dhe pjeserisht nga 60% e te ardhurave qe vine nga regjistrimi dhe tarifat e sherbimit qe paguhen nga klientet. Aktuliasht 40% e te ardhurave nga tarifat derdhen ne buxhet. Sipas ketij rregulli, agjensia njekohesisht merr dhe jep para shtetit cka mund te ristrukturohet per te thjeshtuar rregullat e shpenzimit. Nje ristrukturim i tille do ta shtrengonte agjensine qe te siguronte te ardhura per progrmet e saj per te promovuar nje treg aktiv dhe funksional te tokes.

Objektivat Financiar te te Ardhmes

Synimi eshte qe te zhvillohet ne j strukture e financimit dhe e pageses se tarifave ne menyre qe agjensia te behet nje organizate plotesisht e vete financiar per sa i perket shpenzimeve per drejtimin operacional normal dhe kostot variable. Per te arritur kete agjensia duhet te rrise ne menyre progressive tarifat e saj duke arritur nivele progresive brenda tre vjeteve financimi nga shteti do te zvogelohet ne menyre progresive dhe agjensia do te lejohet te mbaje te ardhurat e saj nga tarifat per te mbuluar ecurine operative normale dhe kostot variable. Per te mbajtur statusin e nje agjensie si nje subject qe financohet nga shteti (gjysem-buxhetore), ajo do te marre mbas tri vjetesh vetem nje financim simbolik. Nje shume nominale. Per te siguruar interesat e publikut dhe te klienteve, ndyshimet e tarifave do te vazhdojne te miratohen nga Keshilli i Ministrave.

Investimet

Ky dokument presupozon vazhdimin e financimit nga jashte qofte nga ndihma e huaj, qofte nga qeveria per plotesim e regjistrimit fillestar ne Shqiperi dhe per investimet e medha kapitale si ato qe lidhen me akomodimet dhe ato me rrjetin kompjuterik.

6 Personeli dhe politikat e trainimit.

Agjensia do te percaktoje dhe ndjeke praktikat me te mira per rekrutimin e personelit, zhvillimin dhe trajnimin e stafit, per vleresimin, nxitjen dhe nxjerrjen ne pension dhe largimet nga puna.

Politikat dhe procedurat per secilen nga keto fusha do te publikohen ne manualin e punonjesve, qe do tu behet i ditur te gjithe punonjesve.

Punonjsve do tu behen te qarta mundesite qe mund te ekzistojne per promocionin ose transferimin ne vende pune te reja, dhe ne qofte se jane te kualifikuar sa duhet, kane eksperience, arsim, performance, vjetersi ne pune, do te jene ne gjendje te aplikojne ne vende vakante.

Ne rastet ku ka vende bosh, ato duhet te reklamohen dhe te plotesohen nepermjet nje procesi seleksionues konkurues te hapur.

7. Marrdheniet me institucionet e tjera.

Agjensia do te mbaje marrdhenie formale dhe pune me institucione te tjera publike ose private qe kane te bejne me ceshtjet e tokes, me transferimin e te drejtes sa pasurive te paluajtshme dhe hipotekimet. Kryeregjistruesi duhet te inkurajoje keshillimin per te gjitha ceshtjet qe do te ndikojne zhvillimin e tregut te tokes dhe hipotekes. Kur eshte e pershtatshme mund te krijohen komitete keshillimor te perbashket qe duhet te takohen te pakten nje here ne vit per te kembyer informacion per politikat, praktikat dhe per te diskutuar problemet qe ekzistojne. Agjensia duhet te raportoje nje here ne vit mbi keto konsultimene raportin e vet vjetor ne Keshillin e Ministrave.

8. Rishikimi i Dokumentave

Dokumentet mund te rishikohen dhe te amendohen ne cdo kohe me kerkese si te Keshillit te Ministrave ashtu dhe te KryeRegjistruesit por normalisht ato duhet te rishikohen nje here ne 4 vjet.

9. Komponentet e Planit

Hartimi i Biznes Planit 2001 – 2004 ka ne themel synimin per te krijuar bazat per kalimin e sistemit ne statusin e nje Institucioni te Pjeseshem Buxhetor. Po ashtu te gjithe ndryshimet dhe permiresimet synojne stimulimin e rregjistrimit te pasurive te paluajtshme si dhe te tregut te tokes si nje nga premiset baze per funksionimin e sistemit te ekonomise se tregut dhe parakusht per terheqjen e investimeve te huaja.

I nisur si Biznes Plan, gjate punes “studimi” ka marre me shume natyren e hartimit te nje strategjie, por qe eshte patur kujdes per tranzicionin dhe impaktin sa me te shpejte ne sistem.

Me perfytyrimin e natyres se re juridike te sistemit u pergatit Drafti i Ligjit te amenduar te AKRPP, cka krijoi mundesine per hartimin e pjeseve te tjera te planit si marrdheniet me institucione te tjera, ndryshimet dhe permiresimet organizative, hartimi e planit financiar te

balancuar qe konsideron statusin e ri te sistemit dhe ndryshimin e tarifave dhe fluksin e parashikuar te aplikimeve.

Perllogaritja e vellemit te aplikimeve ne njesi konvencionale, sipas rretheve e rajoneve krijoi kushtet per perllogaritjen e treguesve te performances dhe vleresimin e dinamikës së saj, ne nivel sistemi dhe sipas zyrave.

Nje sistem i ri informacioni dhe teknologjia per perpunimin dhe sintetizimin e tij, parashikimi investimeve perkatese krahas atyre per te zgjeruar e permiresuar aftesite akomoduese te sistemit, ka qene e domosdoshme te zgjidhen ne plan strategjik e aftagjate, per shkak te natyres por edhe te sforcimeve te konsiderueshme financiare qe kerkojne.

Permiresimi i cilesise dhe zgjerimi i games se sherbimeve qe ofron Agjensia, dhe kenaqja e konsumatorit jane pare te lidhura ngushte me seleksionimin dhe trajnimin e stafit te Agjensise.

Percaktimi i skemes se si sistemi i ri te kete elemente maksimale te “tregut” dhe nje kohesisht do te ruaje karakterin publik, eshte pase parysh pervoja perendimore (angleze, amerikane, kanadeze) por edhe te vendeve te lindjes. Institucionet pjeserisht buxhetore ne Shqiperi, Ndermarrjet Shtetore, Shoqerite Anonime me pronar ose partner shtetin shqiptar kane ofruar elemente racionale te natyres financiare, dhe te organizimit, mbikqyrjes e manaxhimit qe jane shfrytezuar ne skemen e propozuar.

Gjate hartimit te planit te biznesit pavaresisht se eshte hartuar per periudhen 2001 – 2004, ka qene e domosdoshme qe te krijohet nje vizion per ardhmerine e sistemit ne periudha mjaft me te gjata kohe duke pase parysh ndryshimin e situates pas perfundimit te rregjistrimit fillestar.

Megjithate jane evidentuar veprime qe japin impakt afatshkurter ne sistem si permiresime te sherbimeve dhe te marredhenieve me klientet, sistemi i informacionit sidomos te perpunimit te informatizuar te atij kontabel, propozimi me shpejte i ndryshimit te tarifave edhe para ndyshimit te ligjit duke qene kompetence e qeverise etj.

Grupi i punes ka marre informacionin e duhur ne Zyrat e Rretheve duke vizituar disa prej tyre te konsideruara perfaqesuese, si dhe ka siguruar informacionin te shkruar nga te gjitha zyrat per ceshtjet themelore te studimit si per statusin ligjor, riformulimi dhe vleresimi i tarifave, riorganizimi i sistemit etj.,. Jane bere edhe vrojtime te klienteve ne zyrat e rregjistrimit.

Kalimi nga system, i vjeter ne AKRPP kerkon nje periudhe tranzicioni e cila per elemente te ndryshem te biznes planit kerkojne kohe te ndryshme. Per kete jane percaktuar afatet maksimale per realizimin e tyre, pjese e ketij biznes plani. Miratimi ne princip i Biznes Planit ne Qeveri dhe pershpejtimi i procedures se amendimit te Ligjit me aktet perkatese nenligjore dhe Miratimin e tarifave te reja nga K.M. do ti hapnin rruge implementimit ne kohe te Biznes Planit qe do te ndikonte ndjeshem pershpejtimin e perfundimit te rregjistrimit fillestar dhe perfitimn e karakteriastikave te konsoliduara te institucionave analoge.

Propozimi per Qeverine me argumentet qe do te shoqerojne Biznes Planin i bashkendjiten ketij materiali.

Studimi ka pasur konsulencen mjaft te dobishme te Z. John Manthorp (ish Kryerregjistruer i Britanise se Madhe per nje periudhe te gjate kohe) te Zj. Helen Schutten dhe te asistences se

huaj (Mark Marquardt & David Stanfield) Gjate hartimit kemi pasur mirekuptimin dhe sugjerimet e Kryerregjistruarit z. A. Dubali.

9. A Regjistrimi i Tokave – Ligji dhe Procedurat

9. A. 1 – Ligji dhe Statuti

Eshte arritur ne perfundimin qe Agjensia do te kete statusin e nje Institucioni pjeserisht buxhetor. Pas konsultave intensive me juriste, eksperte kontabel, administratore publike ne administraten qendrore dhe profesioniste te tjere, rezulton qe sistemi mund te kthehet ne nje Institucion pjeserisht buxhetor qe te rregullohet me Ligjin per Ndermarrjet Shteterore dhe Ligjin e amenduar te AKRPP (SRPP) me permiresimet qe konsiderojne te qenurit sherbim publik, pa qellim fitimi, dhe faktin qe tarifat do te vazhdojne te miratohen nga KM. AKRPP fiton mjaft avantazhe me ndryshimet e mesiperme ligjore:

- Rrit shkallen e pavaresise se Agjensise ne fushen e organizimit dhe drejtimit
- Rrit ne nje mase te kenaqeshme pavaresine ne fushen e shperblimit, motivimit te punonjesve dhe terheqjes se stafit te kualifikuar
- Te qenurit pjeserisht buxhetor ruan sistemin nga oshilacionet e rastit te vellimit te aplikimeve.
- Siç duket nga plani financiar i hartuar, te pakten deri ne kohe n qe m, bulon biznes plani nuk ka kosto financiare per shtetin, perkundrazi ai lehtesohet.

Ne kuader te ketij ndryshimi do te ndryshohet edhe emertimi i institucionit nga Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ne Agjensi Kombetare e regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme dhe Zyrat neper rrethe ne Agjensi te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Ne planin financiar perllogaritetet do te behen duke respektuar kerkesat e Ligjit “Per ndermarrjet shteterore lidhur me detyrimet, shpenzimet, amortizimet etj.” Gjithahstu do te behet ndryshimi edhe ne emrtimin e titullarit te institucionit, nga Kryerregjistruari ne Drejtoresh te Pergjithshem.

Ndryshimet e ne ligj i japin Sistemit te regjistrimit statusin e nje ndermarje shterore aktiviteti i te ciles eshte percaktuar qarte ne Statutin e Agjensise.

Neqoftese institucioni jone do te quhet Agjensia Kombetare e Regjistrimi ndryshimet juridike jane si ne **ANEKS 1** Projekt Ligji dhe Projekt Statutii qe konsideron aktet ligjore perkatese.

9. A. 2 Bashkepunimi i AKRPP me Institucione te tjera.

Nisur nga fakti qe prona dhe e drejta mbi te, eshte objekti mbi te cilen operon AKRPP, eshte nje arsye te forte ne drejtim te zhvillimit te bashkepunimit te saj me institucionet e tjera, qofshin keto shteterore apo private. Çdo institucion shteteror apo subjekt tjetër privat, pamvarsisht nga objekti i veprimtarise se tyre, e ka te domosdoshme te kete ne çdo kohe dhe sistematikisht nje informacion te sakte dhe te shpejte mbi pronen dhe te drejten mbi te. Por edhe AKRPP duke qene ne hapat e para drejt konsolidimit te saj e ka te nevojshme te thithe te gjitha informacionet nga subjektet e tjera, per te pasuruar informacionin e vet drejt krijimit te nje GIS-i bashkekohor. Si rezultat i interesit reciprok lind detyrimi i vendosjes se urave te bashkepunimit reciprok me te gjitha institucionet jo vetem mbi baza komerciale por edhe

mirebesimi reciprok. Per kete duhet qe te kete nje reklame me te madh nga ana e AKRPP mbi prespektiven dhe sherbimet qe ofron. Gjithashtu duhet te ndjeke nje politike jo shtrenguese ne lidhje me tarifat e sherbimit te informacionit, duke mos u bazuar vetem tek kostoja ne vendosjen e çmimit por edhe tek ajo se çfare mund te perfitojme nga bashkepunimi perkates.

Per vendosjen sa me te mire te maredhenieve midis institucioneve me kerkesen e Zyres Qendrore eshte miratuar edhe Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr 556 date _____, i cili i detyron te gjitha institucionet te marin informacionin gjeografik nga Zyrat e Regjistrimi. Kjo ben qe te krijohet nje maredhenie me e mire midis ketyre institucioneve per te parandakuar cdo perplasje dhe pasaktesi ne percaktimin e pasurise.

Maredhenien te ndersjellta duhet te kete edhe me dhomen e noterise duke percaktuar qarte qe ne veprimtarine e tyre gjate hartimit te aktit noterial te marin informacionin si gjeografik dhe ligjor vetem nga Zyrat e Regjistrimit. Ne strukturen organike te AKRPP eshte parashikuar edhe krijimi i nje Zyre noterie prane AKRPP mundesisht si aktivitet i saj, qe do te lehtesonte mjaft maredheniet midis subjekteve dhe klienteve, do te shmangte nje sere anomalish qe krijohen aktualisht e qe ndikojne garancine e rregjistrimit. Po ashtu te ardhurat nga aktiviteti noterial do te ishin te konsiderueshme per Agjensine.

Vendosja dhe racionalizimi i bashkepunim me keto institucione krijon perfitime te ndersjellta per te gjitha institucionet dhe permireson e lehteson sherbimin ndaj klienteve.

KOHA E PARAQITJES SE BIZNES PLANIT NE KM _____

Koha e Paraqitjes se Projekt Ligjit te amenduar te AKRPP _____

9. B Organizimi

Srukтура Organizative e AKRPP dhe e hallkave te saj vartese.

Ne pikpamje organizative permiresimet qe jane projektuar kane te bejne me:

- a. **Projekti i nje strukture te re organike te AKRPP (ANEKS 2)**
- b. **Organizimi i Agjensive rajonale dhe Lokale te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme (ARRPP dhe ALRPP), (ANEKS 3)**
- c. **Kategorizimi i agjensive rajonale dhe te rretheve ne kategori sipas vellimit te aplikimeve te shprehuara ne njesi Konvencionale, me vlera komplekse per manaxhimin e Sistemit (ANEKS 4) si dhe propozimi per strukturen dhe numurin e punonjesve per secilen kategori (ANEKS 5)**

a. Ndryshimet kane synuar rritjen e pergjegjesise se stafit drejtues per departamentet kryesore te Agjensise, krijimin e strukturave qe sot mungojne qe lidhen me permiresimin e sherbimit ndaj klienteve, marketingut, permiresimin e informacionit, dhe te prognozimit zhvillimit te sistemit. Struktura e re organizative nuk kerkon kosto shtese si dhe konsideron pervojat me te mira te vendit dhe nderkombetare. Disa ndryshime si krijimi i Keshillit Drejtues si organ konsultativ i Drejtorit te AKRPP lidhen me zbatimin e kerkesave te Ligjit per Ndermarrjet Shteterore, por edhe me faktin qe i krijojne mundesine Drejtorit te thithe

konsulencen e specialisteve me te mire gjate vendimmarrjeve komplekse qe ofron kjo periudhe e zhvillimit te sistemit. Vendosija ne strukture e sektorit te noterise do te zgjidhte mjaft probleme qe sot cenojne sherbimin ndaj klienteve dhe sigurine e vertetesine e informacionit

a. Struktura e AKRPP

Struktura e propozuar pas miratimit do te kete nje periudhe kohe qe te plotesohet ne vartesi te rritjes dhe konsolidimit te veprimtarise se sistemit. Ne stuktoren qendrore do te shtohet nje Zv/ Kryetar. Do te shtohet nje departament per regjistrimin me tre sektore (Sektori i Regjistrimit dhe Noterise, Hartografi –Arshive dhe Teknologjise Informacionit, Sektori Juridik dhe Ligjshmerise). Ne Departamentin Ekonomik dhe Administrativ, do te shtohet Sektori i Buxhetit. Ne Departamentin e Programin – Zhvillimit do te permbliidhen kater sektore, Sektori i Investimeve dhe Sherbimeve , Sektori i Marketingut, Statikistes dhe Propagandes i Programim Zhvillimit dhe Sektori informacionit dhe marredhenieve me publikun. Pra struktura do te kete kater departamente, 12 sektore, 9 drejtori Rajonale dhe 37 Agjensi te regjistrimit lokal.

b. Agjensite Rajonale te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme (ARRPP)

Per te lehtesuar kordinimin dhe mbikqyrjen normale te AKRPP mbi strukturat lokale te regjistrimit te pasurise te paluajtshme qe egzistojne sot do te krijohen dhe funksionojne ARRPP. Ato drejtohen dhe kontrollohen nga AKRPP. Mendohet te kene struktura te lehtesuara te manovrueshme dhe efektive. Numri i punonjesve te jete 6 deri ne 9 vete. Ne perberje te Agjensive Rajonale te kete 4 Sektore, Sektori Arkiv- Informacion, Sektori Tekniko- Ligjor, Sektori i Finances – Administrim dhe Sektori i Publikimit dhe Sherbimeve. Agjensite Rajonale, organizojne, drejtojne dhe kontrollojne punen dhe veprimtarine e Agjensise Lokale te Regjistrimit.

Eshte gjykuar qe me kalimin e kohes, me ndryshimin e vellimit te aplikimeve sidomos pas perfundimit te regjistrimit fillestar, me permiresimet infrastrukturore dhe te komunikimit, sherbimi mund te arrihet nga klientet ne Agjensite Rajonale te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme, duke ofruar edhe sherbimin shetites (Pervoja Kanadeze) ne dite te caktuara te javes ne qendrat e rretheve.

Agjensite Lokale te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme (ALRPP)

Ato do te organizohen mbi bazat ekzistuese qe kane sot Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme. Numri tyre te jete ai qe eshte sot plus krijimin e dy agjensive te reja qe mund te krijohen ne rrethet Has dhe Delvine.

Numri i punonjesve ne agjensite lokale do te jete ne vartesi te vellimit te aplikimeve qe realizojne te shprehur ne Njesi Konvencionale, (NJ.K) duke reflektuar karakteristikat e rretheve.

Struktura e re rajonale dhe organigrama eshte pasur parasysh ne te gjitha pjeset e tjera te planit dhe mendohet se mund te funksionojne plotesisht ne vitin 2004.

c. Kategorizimi i ARRPP dhe ALRPP

Mbi bazen e vëllimit të aplikimeve të shprehura në NJ.K është bërë kategorizimi i Agjencive Rajonale dhe Lokale, që përben një bazë të mirë për planifikimin financiar, personelin dhe menaxhimin efektiv të tyre.

Është gjyklarë që Agjencitë që realizojnë deri në 1000 Nj.Kv/ punonjës, do të kategorizohen ALRPP të kategorisë të tretë, ato me 1000 - 2000 Nj. Kv / punonjës do të jenë të kategorisë së dytë dhe ato mbi 2000 Nj. Kv/ punonjës do të kategorizohen të kategorisë së parë.

Si përfundim, nga ky kategorizim do kemi 16 agjenci lokale të kategorisë së parë, 9 agjenci të kategorisë së dytë dhe 10 agjenci lokale të kategorisë së tretë.

9. C Personeli

Është grumbulluar dhe përpunuar informacioni i detajuar për personelin, karakteristikat sipas zyrave egzistuese dhe sipas 12 zyrave rajonale dhe zyrave të rrethëve, për karakteristikat si moshë gjinia, arsimimi, kualifikimi, njohja e gjuhëve të huaja. (**Aneksi 6**) si dhe të dhënat për secilin nga 240 punonjësit e sistemit (**Aneksi 7**) të dhënat e përmbledhuara sipas karakteristikave të mësipërme për 2 zyrat e Tiranës, Zyren Qendrore dhe gjithsej për sistemin janë si më poshtë:

Te dhëna përmbledhëse për karakteristikat e personelit

Treguesit ____Nj esite	Nr. punonj esve	Nga keto femra	25-35 vjeç	36-50 vjeç	Mbi 50 vjeç	Arsim 8 vjeçar	Arsimi mesm.	Ars. Lartë	Ars. Pas. Univer sitar	Me dy fakultete
Tirana 1	18	13	9	8	1	2	1	15	-	1
Tirana 2	5	4	2	3	-	-	1	4	-	-
Zyra qendro re	32	17	15	15	1	1	3	28	2	1
Gjithse j	240	132	74	134	32	3	39	198	2	3

Treguesit ____Nj esite	Anglisht	Italisht	Te tjera gjuhë te huaja	Inxhi nier	Agro nom	Ekono mist	Shkenca shoqerore	Te tjera	Kualifi kim br. Vendit muaj	Kualifikim jashtë vendit muaj
Tirana 1	8	2	1	4	1	3	7	3	15	1
Tirana 2	2	-	1	2	-	1	1	1	5	-
Zyra qendro re	20	8	4	3	4	6	3	2	2	2
Gjiths ej	57	21	26	54	37	48	44	44	195	7

Te dhenat e mesiperme si dhe ato te Aneks 6.7 pervec qe japin bazen per nje analize te thelluar gjeografike te gjendjes se personelit, do te ndihmojne edhe per pershkrimin e punes (Job Discription) dhe percaktimin e karakteristikave qe do te kerkohen per çdo vend pune ne te ardhmen gjate rekrutimit te punonjesve te rinj, apo per standartet qe duhet te plotesojne punonjesit ekzistues per te ruajtur vendin e punes ne kushtet e sistemit te ri te rregjistrimit.

Jane llogaritur treguesit e produktivitetit dhe te peformances (Njesi konvencionale per nje punonjes) sipas rretheve dhe rajoneve **Aneks 8** ku verehen dallime te medha nga nje rreth dhe rajon ne tjetrin)

Sa per nje shembull theksojme se ka diferenca te medha midis rretheve me kushte te ngjajshme edhe te te njejtir rajon. Keshtu treguesi Njesi Konvencionale aplikimi per nje punonjes ne disa rrethe per vitin 2001 eshte:

Tirana1 2750, Berati 1465, Durresi 2124, Korça 1837, Elbasani 1490, Fieri 1461, Tirana 2 1158, Gjirokastra 801 dhe Vlora 131!

Bulqiza 179, Dibra 427, Gramsh 728, Mallakaster 253, Mirdite 221, Peqin 225, Puke 97, etj.

Diferencat e mesiperme nuk mund te justifikohen me “veçoritë e rretheve” por me diferencat ne produktivitetin dhe efikasitetin e punes se punonjesve apo ne numurin e fryre te organikes me dallime te konsiderueshme midis rretheve. Kjo kerkon nje analize te thelluar per çdo zyre duke inicuar nje process reformues te sistemit edhe ne kete pikpamje.

Per kete politika e personelit do te konsistoje ne:

- Respektimi i normave te ligjit “ Per sherbimin e nenpunosit civil te Republikes se Shqiperise”
- Te rishikohet dhe zhvillohet strategjia e trajnimit dhe zhvillimit profesional te punonjesve te regjistrimit, per te siguruar perdorimin e plote dhe efektiv te aftesive menaxhuese te stafit.
- Te shikohet mundesia e vazhdimesise se funksionimit te grupit te punes se Biznes Planit te pakten deri ne periudhen e miratimit dhe fillimit te implementimit te tij.
- Ne sistemin e regjistrimit, stafet e punes te krijohen kryesisht me juriste, inxhinier gjeodet, agronome, ekonomiste dhe me nje mase te kufizuar njerezish nga profesione te tjera, sipas kerkesave per çdo vend pune.
- Pranimi i punonjesve ne zyrat e regjistrimit te behet me konkurs te hapur dhe publik. Konkurimi behet ne baze te karakteristikave te miratuara per cdo vend pune per arsimimin, moshen, eksperiencen, stazhin ne pune etj, qe publikohen ne media.
- Te percaktohen trajnime ditore dhe javore rajonale ose kombetare me grup punonjesish sipas profesioneve apo vendeve te punes.

- Per përgatitjen dhe kualifikimin e punonjeve të regjistrimit të hapen dhe të funksionojnë kurse njevjeçare, pranë AKRPP.
- Të bëhet rregull, që në vendet drejtuese të vendosen profesioniste me përvojë pune, karakteristika etiko – morale të spikatura, duke parapelqyer kandidatet me kulture profesionale, të motivuar, që njohin gjuhë të huaja, kanë kualifikime të ndryshme dhe tituj të grada shkencore.
- Profesionet e lira, si noterizimet, vleresimet e pasurive të paluajtshme etj, mund të përfshihen dhe të bëhen pjesë e veprimtarisë dhe aktivitetit të AKRPP

9. D Trajnimet

Lidhur me trajnimet, përveç realizimit të planit të trajnimeve që ekziston në sistem me miratimin e Biznes Planit do të organizohen Seminare për prezantimin e tij në shkallë kombëtare dhe rajonale, për të familiarizuar punonjësit me Sistemin e ri, si dhe për çështje të veçanta si:

- Ligji dhe Statusi i AKRPP dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera.
- Interpretimi i tarifave të reja dhe relacioni me kartelat
- Struktura e re organike, përshkrimi i vendeve të punës dhe rregullat e rekrutimit
- Aspekte teorike dhe praktike të planifikimit financiar dhe investimeve në sistemin e ri. Performanca e punës dhe e sistemit.
- Marketingu dhe plotësimi i kërkesave të subjekteve institucionale dhe familjare
- Sistemi dhe teknologjia e grumbullimit të informacionit në AKRPP

Punonjësit të AKRPP dhe specialiste të tjera do të referojnë në seminarët e mësipërme duke siguruar edhe feedback-un përkatës për përmirësimin e biznes planit në implementim të siper.

9. E Volumi i veprimeve

Plani i aplikimeve ose veprimeve të Agjensisë (**Aneks 9**) merr parasysh të pritshmin e këtij viti, dinamikën e kaluar dhe të ardhmen e procesit të regjistrimit. Ka qenë pjesa që ka pasur më shumë diskutime sepse nga shkalla e saktësisë së parashikimit varet suksesi i sistemit. Gjykohet që plani i aplikimeve është realistik dhe me një shkallë të lartë sigurie.

Po kështu janë llogaritur vëllimi i aplikimeve në Njësi Konvencionale, për çdo rreth dhe sipas rajoneve për vitet 2001 - 2004 (**Aneks 10**) çka bëri të mundur rritjen e shkallës së krahasueshmërisë në kohë dhe midis agjensive si dhe përlllogaritjen e treguesve të produktivitetit dhe të performancës. Në përlllogaritjen e Njësi Konvencionale janë marrë për bazë tarifat e reja. Është bërë një përpjekje për të llogaritur Njësi Konvencionale *ne baze të kohës* që përputhej me përlllogaritjet e bëra në vlerë.

Parashikimi i vëllimit të njësi konvencionale të aplikimeve është bazuar në:

- Grupimin e ri të shërbimeve shoqërorar me tarifën e reja.

- Ne evidencen permbledhese te ardhurave te vitit 2000 te njehsuar me sherbimet dhe tarifat e reja.
- Ne te dhenat e 5 /Mujorit te vitit 2001 per çdo Zyre Regjistrimi.

Per te percaktuar volumin e njesive konvencinale te aplikimeve kemi marre si sherbim etalon " Leshimin e çertifikatave dublikatave dhe vertetimeve te pasurise" per dy arsye:

Se pari: Sherbimi i mesiperm eshte sherbimi me frekuence me te larte ne krahasim me sherbimet e tjera, pasi ky sherbim aplikohet jo vetem per marrje çertifikate si dokument pronesie por edhe per cdo kalim pronesie.

Se dyti: Tarifa e ketij sherbimi ka vlere te njejte edhe me dy lloj sherbimesh te tjera gje qe lehteson punen ne llogaritjen e ketij volumi.

9. F Financimi dhe shpenzimet

Ndryshimi i statusit te Agjensise si dhe ndryshimi i sistemit te tarifave bene qe plani financiar i paraqitur te perlllogaritur me tarifat e reja, vellimin e parashikuar te aplikimeve si dhe kerkesat e supozuara te Ligjit qe parashikon ndryshime ne shpenzimet dhe detyrimet e sistemit. Ne anekset jane te dhenat analitike per:

Te ardhurat shpenzimet dhe rezukltati financiar sipas rajoneve (ANEKS 11) dhe sipas rretheve (ANEKS 12) si dhe Te ardhurat sipas llojit te aplikimeve dhe rajoneve per periudhen 2001 – 2004 (ANEKS 13)

Me aplikimin e kriterëve qe rrjedhin nga Ligji i ri, Agjensia si Institucion gjysem buxhetor, permireson treguesit financiare, bazuar ne rritjen e performances dhe tarifat e rritura. Nga nje institucion qe financohet nga buxhetiafro 20 %, me ndryshimet ne tre vjetet e pare ballancohet bilanci pa kerkuar financim ose duke derdhur “fitim” ndersa pas vitit te trete do te nevojitet nje subvencionim minimal, (6 milione) shume me pak se financimi i sotem. Subvencionimi i asaj kohe eshte nje “kosto” e vogel ne krahasim me pefitimet nga rritja e pavaresise se Sistemit dhe permiresimet cilesore te sherbimit, duke rekrutuar dhe kompesuar punonjes cilesiore. Ky sistem perputhet plotesiosht me modelet e sygjeruara nga specialste te huaj.

PLANI FINANCIAR

VITET	2000 6/m I, 6/m II	2001	2002	2003	2004
1. Nr i veprimeve	205000	200000	208000	220000	230000
2. Shpenzimet	22000	183000	271000	295000	338000
Nr i veprimeve	205000	200000	208000	220000	230000
Produkti (Vl.e nje aplikimi)	0.6	0.9	1.3	1.3	1.4
3. Ardhurat	120000	(55500, 144000)	300000	317000	332000
Nr i veprimeve	205000	176000	187000	192000	205000
Tarifa mesatare ponder.	585	(630, 1636)	1604	1651	1620

Per vitin 2001 te ardhurat mbahen 60% nga sistemi duke derdhur 40% ne buxhet. Ne kete vit per te llogaritur rezultatin eshte evidentuar vetem pjesa e shpenzimeve qe sigurohet nga te ardhurat. Duke supozuar qe tarifat do te rriten ne 6/Mujorin e dyte dhe buxheti prej 183000 mije leke eshte pjese perberese e buxhetit te shtetit, llogaritjet e te ardhurave jane ndare ne 2 6/mujore.

Rritja e te ardhurave

	Ne 000/ Leke				
3.Ardhurat	120000	(55500, 144000)	300000	317000	332000
TVSH	0	0	60000	63400	66400
<i>Rritja ne %</i>	<i>0</i>	<i>66</i>	<i>50</i>	<i>5</i>	<i>5</i>
Shpenzimet	122000	84000	271000	295000	338000
TVSH	0	0	60000	63400	66400
Fitimi ose humbje te ushtrimit	0	60000	29000	22000	- 6000
Derdhje buxhet 40%	56000	0	0	0	
Tatim fitimi 25%			7000	5500	0
Fitim neto			22000	16500	-6000
F.rezerve 5% + 15% shperblim		4400	3300		

Shpenzimet per 2002 jane parashikuar si me poshte:

Pagat	114000	rritje 100% ne krahesim me vitin 2001
Sig shoq	38000	rritje 100% ne krahesim me vitin 2001
Shp operative	110 000	
Amortizimi	9000	
Shuma	271000	
TVSH	60000	

Shpenzimet per 2003 jane parashikuar si me poshte:

Pagat	137000	rritje 20% ne krahesim me vitin 2002
Sig shoq	44000	rritje 20% ne krahesim me vitin 2002
Shpenzime	100 000	
Amortizimi	14 000	
Shuma	295000	
TVSH	63400	

Shpenzimet per 2004 jane parashikuar si me poshte:

Pagat	164 000	rritje 20% ne krahesim me vitin 2003
Sig shoq	54 000	rritje 20% ne krahesim me vitin 2003
Shpenzime	100 000	
Amortizimi	20000	
Shuma	338 000	
TVSH	66400	

Zyrat e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme realizojne te ardhura gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre. Realizimi i te cilave varet nga dy faktore ;

1. Vellimi i sherbimeve qe kryhen ne keto zyra
2. Tarifa qe aplikohet per cdo sherbim

Duke e konsideruar vellimin e sherbimeve si faktor objektiv, ne kemi menduar te rrisim te ardhurat e sistemit nepemjet rigrupimit te sherbimeve dhe rritjes se tarifave rreth 2 here me shume se tarifate ekzistuese. Kjo rritje eshte bere duke marre ne konsiderate kohen e shpenzuar per cdo lloj sherbimi.

Per llogaritjen e shpenzimeve te sistemit ne kemi patur parasysh strukturen e tyre sic eshte pasqyruar ne projekt planin financiar per vitet 2001 - 2004.

Perllogaritja e pagave dhe kontributit te sigurimeve shoqerore eshte bazuar ne numrin aktual te punonjesve te sistemit te Regjistrimit (242 punonjes).Duke filluar nga viti 2002 eshte parashikuar te rriten pagat 100% ne krahesim me pagat aktuale. Kjo rritje pagash do te motivoje punonjesit per te rritur cilesine e sherbimit ndaj klientit. Meqenese vitin e pare te kalimit me vetfinancim pagat rriten 2 here eshte menduar duke patur parasysh dhe limitet e percaktuara nga qeveria, qe rritja ne vitet 2003 dhe 2004 te jete 20% ne krahesim me vitin paraardhes.

Parashikimi i shpenzimeve operative eshte bazuar ne nevojat e sistemit ku dhe nje pjese e kesaj shume perbehet nga shpenzimet per publikime te cilat do jene teper te nevojshme me kalimin e sistemit me vetfinancim.

Perllogaritja e fondit te amortizimit eshte bazuar ne vleren e aseteteve te qendrueshme te trupezuara qe ka ne fakt sistemi si dhe ne normat e amortizimit te percaktuara nga qeveria.

Fondi i amortizimit i llogaritur per sistemin eshte i ulet pasi, vlere e zyrate te regjistrimit ne rrethe nuk eshte e regjistruar ne librat kontabile te sistemit, per arsye se ato jane objekte inventari te pushtetit lokal.

Si element shpenzimi eshte futur dhe TVSH, por ne lidhje me kete nuk jemi te sigurte per arsye se qellimi i veprimtarise se sistemit, nuk duhet te jete fitimi, sic eshte percaktuar ne nenin 1 te ligjit mbi krijimin e ndermarjeve shteterore, per mos futjen e ketij elementi (TVSH) pasi rriten pagesat per klientin ne masen 20%, gje qe rendon me shume xhepin e konsumatorit.

Ne mbeshtetje te ligjit nr 7928 date 27.04.1995 " Per tatimin mbi vleren e shtuar" dhe Udhezimit te Ministrise se Financave nr 8 date 05.01.2000 pika 6.5 agjensia jone do te klasifikohet ne organizate jo fitim prurese me qenese objekti i saj eshte i tille.

9. G Te ardhurat nga tarifate

Pjese e planit me te cilen eshte filluar puna e grupit. Pas diskutimesh te 5-6 drafteve, konsultash ne rrethe etj eshte percaktuar Lista e re e Tarifave. **(ANEKS 14) qe shoqerohet me tarifate egzistuese dhe mesateret sipas rretheve (ANEKS 15)** Ato jane mbi 60 % me te larta, jane te grupuara ne 9 tarifa, te shprehuara sipas terminologjise dhe perkatesise se kartelave te rregjistrimit, jane me te interpretueshme dhe te kontrollueshme. Jane parashikuar sherbimet qe do te shiten vec aplikimeve te rregjistrimit si dhe efekti i tyre ne planin financiar te ndermarrjes.

Sistemi i ri i tarifave i cili konsideron propozimet e rretheve si dhe eshte konsultuar me nje pjese te rregjistruesve me pervoje.

Nga 21 tarifa egzistuese janë shtuar 11 të reja që nuk ekzistojnë dhe deri tani operohen për analogji ose me miratim të kryerregjistruesit. 32 tarifat janë agreguar në 9 gruptarifa të reja, sipas kriterit të çmimit, dhe përkatesin në kartelen e rregjistrimit të zerave përkates.

Nga një analizë paraprake e sistemit të ri tarifave rezulton që përparesitë tejkalojnë dukshëm mangësitë.

PERPARESI

1. Përfshihen 11 tarifa që nuk ekzistojnë të miratuara por që si aplikime ekzistojnë
2. Tarifat e reja janë me të kuptueshme, identifikueshme lidhur edhe me zerat e karteles dhe pakesojnë konfuzionin që krijohet me interpretimin e tyre gjatë aplikimeve.
3. Ulin shkallën e subjektivitetit në interpretim si dhe fenomenet e padëshirueshme që shoqërojnë ato
4. Rritet mundësia e kontrollit dhe evidentimit me më pak sforcime
5. Niveli i tarifave të reja është shumë më tepër i mbështetur në koston e tyre dhe i krahasueshëm me shërbime të ngjajshme në institucione të tjera publike.
6. Zerat janë grupuar sipas natyrës dhe specifikave duke respektuar kriterin rigoroz juridik.
7. Niveli i tarifave krijon premisat në rrugën e kalimit të sistemit të rregjistrimit në një sistem publik të vetefinancueshëm.
8. Sistemi i ri i tarifave është me prapësi modelevë përendimore përkates.
9. Miratimi i këtij sistemi nuk kërkon ndryshime ligjore por vetëm të Këshillit të Ministrave në vartësi të të cilit është Qendra Kombëtare e Rregjistrimit.
10. Lehtëson informatizimin e të dhënave dhe ul koston e tyre.

MANGESI

1. Kërkon sforcime për:
 - të arritur mirekuptimin me Qeverinë dhe me Klientet
 - ndryshimin dhe përshtatjen e sistemit të evidentimit dhe të pagesave
 - sigurimin e krahasueshmerisë së të dhënave në dinamike dhe strukturën sektoriale dhe gjeografike, si dhe për konsolidimin e të dhënave të rrethëve në nivel kombëtar.
2. Kosto e marketingut dhe trajnimit të punonjësve.

Mendohet dy alternativa të ngritjes graduale dy tre hapash apo menjëherë. Në plan financiar është pasqyruar alternativa e ngritjes së menjëherëshme të tarifave

9.H Puna dhe performanca – Sherbimet e reja.

Per performancen e sistemit te ri flasin treguesit e produktivitetit te shprehuara ne NJ.K. per punonjes si dhe treguesit e kosos per njesi konvencionale aplikim dhe te dhenat per te ardhurat dhe shpenzimet e rezultatin financiar qe pasqyrohen ne planin financiar per periudhen 2001 – 2004. Perfitimet nga reformimi i sistemit jane me shume se aq.

Shteti lirohet nga detyrimi buzhetor per AKRPP, rritet motivimi i punonjesve, nepermjet kompesimit me te mire, krijimit te kushteve moderne ne mjediset e punes, rritja e shkalles se garancise dhe sakesise se informacionit, rivleresimi i konsumatorit (klienteve duke u vene ne themel lehtesimi i komunikimit, krijimi i mundesive te apelimit dhe ankesave, rretja e shkalles se transparenc dhe e pergjegjesise individuale, per detyrat e percaktuara ne Job Description.

Saktesimi i pronesise se tokes dhe pasurive te tjera do te nxise investimet vendase dhe sidomos ato te huaja. Jane nje sere efektesh shoqerore dhe ekonomike ne shkalle vendi qe eshte veshtire te maten ne kuadrin e ketij studimi por ato realisht shoqerojne riorganizimin e sistemit dhe pershejtojne zhvillimin e vendit.

Natyrisht kalimi me sistemin e ri “pothuajse vetefinancues” kerkon edhe mobilizimin e burimeve te tjera per shtimin e te ardhurave te AKRPP, me shitjen e produkteve qe lidhen drejt perdrejte me veprimtarine e Agjensise, sic jane informacioni. Ne studim jane analizuar dhe planifikuar te ardhurat qe mund te vijne nga shitja e informacionit te silat rrisin performancen e shkallen e sigiruse se vetefinancimit te sistemit te shoqeruar me permirtesimin e sherbimit te klienteve ne pergjithesi.

Ne kushtet e nje ekonomie te tregut te lire padyshim informacioni eshte nje hallke e rendesishme ne zhvillimin dhe konsolidimin e aktiviteteve dhe sherbimeve te ndryshme private apo shtetore qofshin ato. *Informacioni topografik ne vecanti ashtu edhe ai gjeografik* ne pergjithesi ka rendesine dhe vlerat e veta si informacioni baze mbi te cilin merr zanafillen e vet çdo studim qe kryhet ne çdo fushe te veprimtarise njerezore.

Nje rol te rendesishem ne grumbullimin, perpunimin dhe shitjen e ketij informacioni mund dhe duhet ta luaj Sistemi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme. SRPP-ja vec zhvillimit dhe persosjes se aktivitetit te vet primar duhet gjithashtu te orientohet ne drejtim te pasurimit te informacionit gjeografik, te cilin mund ta ofroje subjekteve vrivate apo publike te interesuar. Ky sherbim aktualisht eshte modest, megjithese verehet nje prirje rritje si rezulktat i presinit te kerkeses per te

Prane Zyres Qendrore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme kane ardhur kerkesa per harta topografike kryesisht per zonat urbane te qyteteve te shkalles 1:500 te cilat jane sherbyer ne kohe. Keshtu per vitin 2001 kemi patur kerkesa nga filialet e Telekomit te rretheve Berat dhe Elbasan. Keshtu per dy muajt e pare te vitit 2001 jane shitur 119 cope plansheta te shkalles 1:500 per te dy rrethet se bashku. Nje harte e shkalles 1:500 shitet nga ana jone me 816 lek. Me subjektet e interesuara per te blere keto harta eshte lidhur edhe nje marveshje e perbashket per te garantuar qe keto harta nuk do te shumfishohen si dhe per te sjell informacionin e azhornuar prane zyrave tona i cili do te sherbeje ne pasurimin e informacionit gjeografik.

Gjithashtu prane zyres tone kane ardhur kerkesa edhe nga institucione te tjera per informacionin dixhital (hartat e dixhitalizuara), por per Zhvillimin dhe persosjen e sherbimit te shitjes se informacionit grafik dhe dixhital duhet:

Se pari, ruajtja me rigorozitet e te drejtes se autorit nga ana e SRPP mbi informacionin topografik ne vecanti dhe ate gjeografik ne pergjithesi, qe behet e mundur vetem me krijimin e arshives se SRPP-se. Per periudhen qe po kalojme ne nje kohe qe informacioni topografik mund te sigurohet nga subjektet e interesuara edhe ne rruge te tjera jo legale, ruajtja e te drejtes eskuzive, si nje veprimtari legale, ne shitjen e ketij informacioni do te ishte shume e rendesishme. Per kete duhet te orientohemi ne praktika te tilla ku informacioni i shitur te shoqerohet edhe me elemente te sigurise te cilat do te benin qe te frenohej konkurenca e pandershme.

Se dyti, orientimi ne bashkpunim edhe me NMP-ne ne hartimin e projekteve te ndryshme mbi menyren e thithjes dhe pasurimin e informacionit prane SRPP-se deri ne konsolidimin e nje sistemi te plote informacioni gjeografik ose siç thirret ndryshe sistemi GIS.

Se treti, menaxhimi i mire i ketij informacioni nga ana e SRPP-se, azhornimi i tij koherent me zhvillimet qe vihen re si dhe sherbimi i sakte, cilesor dhe ne kohe ndaj subjekteve te interesuara, do te krijonte nje baze te shendoshe ne ecjen dhe zhvillimin e ketij lloj sherbimi prane SRPP-se dhe si rrjedhoje edhe vjeljen e te ardhurave financiare te konsiderueshme.

Aktualisht sherbimet qe ofron ZRPP-ja ndaj klienteve te ndryshem te interesuar eshte e kufizuar dhe me probleme per vleresimin e cmuarjen e tyre.

1. Shitja e hartave manuale :

- a.) Per subjektet shtetore816 Leke/planshete**
- b.) Per subjektet private.....5000 Leke/planshete**

Ndersa disa nga sherbimet qe mund te ofroje ZRPP-ja ne te ardhmen ne menyre te permbledhur jane:

1. Shitja e hartave dixhitale

2. Hartimi i planeve te rilevimit nga ZRPP-te

3. Shitja e informacioneve te ndryshme:

- a.) Per mjedisin : dherat dhe gjeologjia; rrymat e ujit; bimesia; bota e eger.**
- b.) Per infrastrukturen : dobite; ndertesat; transporti; komunikacionet.**
- c.) Ligjore : zoterimi; vleresimi; perdorimi i tokes; ligji dhe rregulli.**
- d.) Social-ekonomike : shendeti; mireqenia; regjistrimi i popullise; marketingu.**

Duhet te percaktohet autoriteti qe miraton çmimet e tyre sepse aktualisht ka nje lloj konfuzioni dhe shpesh perdoret menyra e analogjise.

Gjithsesi mbarevajtja dhe ecuria e ketij lloji biznesi do te varet nga politika dhe orientimi ne te ardhmen nga ana e AKRPP, per krijimin e arshives si dhe te nje sistemi GIS me gjithë infrastrukturen e vet, si dhe perpjekiet per ruajtjen e te drejtes se autorit.

Te dhenat e meposhtme per sherbimin e shitjes se hartave treguese te regjistrimit te pasurive institucioneve apo individeve te interesuar per vitet 1999, 2000 dhe tremujorin e pare te vitit ne vazhdim, flasin per nje prirje rritjeje, mbi bazen e te ciles eshtre planifikuar vellimi i shitjes per periudhen deri ne vitin 2004.

Ecuria e shitjes hartave ne vite	Nr.planshetave cope	Cmimi njesi Lek/planshet	TOTALI Lek
Viti 1999	100	816	81.600
Viti 2000	160	816	130.560
Tremujori i pare I vitit 2001	170	816	138.720

Nisur nga ecuria e deritanishme e shërbimit të shitjes së informacionit institucioneve apo individëve të ndryshëm, kryesisht në zërin e shitjes së hartave treguese të regjistrimit, eshte bere parashikimi si vijon.

VITET NE STUDIM	NUMRI I PLANSHETAVE	CMIMI NJESI Leke	SHUMA leke
VITI 1999	100	816	81.600
VITI 2000	160	816	130.560
3-MUJORI i PARE I VITIT 2001	220	816	179.520
VITI 2001	800	816	652.800
VITI 2002	1.000	816	816.000
VITI 2003	1.100	816	897.600
VITI 2004	1.200	816	979.200

Ne keto pak vite jete sistemi krahas konsolidimit te vet, ka arritur te akumulroje nje informacion modest i cili po vjen gjithnje duke u pasuruar si ne sasi dhe ne cilesi. Me celjen e zyrave te regjistrimit u krijuan mundesite, qe krahas veprimtarise se tyre primare te

regjistrimit, te funksionojne edhe sherbime te tjera ne dobi te klientit. Ky sherbim eshte ne hapat e para te tij dhe per momentin konsiston ne shitjen e materialit grafik per zonen urbane dhe ate rurale sic jane Hartat Treguese te Regjistrimit.

Veprimtaria legale e Sistemit te Regjistrimit mbeshetet ne Ligjin Nr. 7843, date 13.07.1994, “Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme”, *por akumulimi, pasurimi dhe menaxhimi i informacionit si dhe orientimi drejt krijimit te nje sistemi GIS (Sistemi i informacionit gjeografik) kerkojne padyshim nje mbeshetje me te plote ligjore.*

Gjithashtu nje sere parakushtesh duhet te plotesohen qe te behet i mundur pasurimi dhe perditesimi, dhe pasqyrimi i ndryshimeve qe ndodhin ne boten perreth:

1. Te krijohet prane Zyres Qendrore te Sistemit te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Departamenti Hartografik. Ky departament do te kete prioritet ne drejtim te hartimit dhe azhurnimit te Hartave Treguese te Regjistrimit qofshin keto manuale apo dixhitale. Gjithashtu duhet te orientohet drejt krijimit te Ortofotove si nje element bashkohor i dhenies se informacionit. Krahes kesaj duhet te hedhe bazat e krijimit te nje Sistemi te Informacionit Gjeografik dhe te zhvilloje me tej stadet e tjera te konsolidimit te tij.

2. Te krijohen prane Departamentit Hartografik, Sektori Topografik, Fotogrametrik dhe i Informatizimit. Sektori Topografik do te merret me perditesimin e hartave baze si dhe do te mbeshetese sektorin Fotogrametrik ne lidhje me pikat mbeshetese fotogrametrike etj. Sektori Fotogrametrik do te merret me perpunimin e fotografive, hartimin e hartave baze, hartimin e hartave te ndryshme si dhe Ortofotove. Sektori i Informatizimit do te jete berthama, i cili do te merret me grumbullimin dhe sistemimin e te gjithe informacionit dixhital qe do te grumbullohet nga burime te ndryshme, me menaxhimin e ketij informacioni, i cili duhet te jete i hapur dhe i aksesueshem per te gjithe te interesuarit.

3. Te vendosen mbi baza te shendosha mardheniet e ndersjellta midis AKRPP-se dhe institucioneve te tjera ne drejtim te shkembimit te informacionit. Keto mardhenie nuk duhet te konsistojne ne qellime ndervartesie por ne shkembimin e informacionit reciprok kundrejt procedurave dhe modaliteteve te miratuara nderinstitucionale.

4. Te krijohet arshiva e pergjithshme e SRPP-se ku pervec anes dokumentare te arshivohet i gjithe materiali manual dhe dixhital qe kane te bejne me pronen.

Duke pasur nje informacion sa me koherent dhe duke e servirur ate ne menyre sa me bashkohore do te kemi rritje te interesit te subjekteve te ndryshme per te, qe padyshim do te shoqerohet me efekte financiare te konsiderueshme dhe do te rrisin perefomancen e sistemit.

Vendosja dhe respektimi i standarteve te cilesise per informacionin. Sistemi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ka detyrimin sipas ligjit por edhe privilegjin ne drejtim te adaptimit, zhvillimit dhe persosjes se standarteve te cilesise se sherbimit, kryesisht sa i perket veprimtarise topografike, drejt standarteve me te perparuara boterore.

Me konkretisht duhet qe te adaptohen standartet topografike European, te cilat bazohen ne rekomandimet e dhena nga NATO. Unifikimi i ketyre standarteve shtrin influencen e vet ne

drejtim të sistemit të referimit, rrjetit kombëtar, projekcionit, shkallës dhe formatit të planshetave të hartave dhe konkretisht:

1. Aktiviteti dhe shërbimet t AKRPP-se.

- *Administrimi i Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në gjithë territorin e Republikës.*
- *Pergatitja e standarteve kombëtare për njësitë e matjeve topografike.*
- *Pergatitja e hartave topografike në shkallë të ndryshme si dhe botimet tematike.*
- *Ruajtja në arkiv e të gjithë materialit topografik dhe hartografik.*

2. Produktet

a) Aktualisht:

- *Te dhëna mbi Pasuritë e Paluajtshme.*
- *Harta kadastrale dixhitale dhe manuale.*
- *Te dhëna mbi kufijtë administrativ.*

b) Në të ardhmen:

- *Te dhëna mbi pikat e kontrollit.*
- *Te dhëna mbi gjeografine, emërtimet, territorin.*
- *Harta topografike.*
- *Modele imazhesh dixhitale.*
- *Te dhëna mbi vlerësimin e tokës bujqësore.*
- *Ortofoto.*
- *Botime tematike.*

9. I Shërbimet ndaj klientit - Marketingu

Një nga pikat kyçe të persosjes së sistemit është marrëdhënia me klientët. Masat që parashikon Biznes plani synojnë të shmangin, rradhën e gjatë në pritje të klientëve për tu shërbyer, vonesat dhe zgjatjet të perfundimit të shërbimit, trajtime të diferencuara nga punonjësit të vecantë të rasteve për motive të diskutueshme, një mjedis jo fort komod për klientët sidomos gjatë kohës së verës, mungesa e transparencës dhe komunikimit me klientët etj. Tarifat e reja më të larta krijojnë detyrimin për një shërbim mjaft me cilësor dhe “njëzëror” të egzistuesit. Tarifa e re kërkon attribute të shërbimeve mjaft larg atyre egzistues.

Se pari, Kërkesa tejkalon ndjeshëm kapacitetin e Sistemit për të shërbyer në kohë dhe me cilësi. Për këtë do të

- zgjerohen dhe përmirësohen kapacitetet akomoduese të sistemit në Qender dhe nëpër rrethë.
- Krijohet rrjeti informatik i sistemit që do të rrisë produktivitetin e do të shkurtojë kohën e përpunimit të informacionit, dhe të shërbimit të klientit, si dhe ulë mundësinë e gabimeve
- Zbatimi me rigorozitet i planeve të trajnimit dhe seleksionimi sipas rregullave të përcaktuara të punonjësve të rinj të sistemit.

- Ne ndonjen rast zgjerimi i rrjetit te zyrave per tju afruar klienteve te pakten ne fazen e rregjistrimit fillestar, si dhe aplikimi i sherbimit shetites ne fazat me te avancuara.
- Krijimi i sektorit te marketingut dhe shitjeve.
- **Informatizimi i kontabilitetit qe deri me sot mbahet me dore eshte urgjent.**

Se dyti, Persosje e komunikimit me klientet,

per ti bere te njohur misionin dhe funksionin e AKRPP, nivelin e tarifave, kohen maksimale qe ata duhet te sherbehen, te drejten e ankimimit ne menyre te organizuar ne strukturat e specializuara per marredheniet me publikun, **pergatitja dhe shperndarja falas e nje fletepalosje me te gjithe informacionin e nevojshem per klientin, pergatitja e pllakateve ne mjediset e Sistemit dhe jashte e deri ne emisionet televizive e publikimet ne mediane shkruar.** Krijimi i **Webb Sight-it te AKRPP ne internet duhet te behet sa me pare.**

Gjate pergatitjes se Biznes Planit u bene perpjekje per te kronometruar kohen e sherbimit per cdo aplikim dhe te vendosen kufijte maksimale te sherbimit te nje kerkese. Me gjithese kerkojne perpunim te metejshem dhe miratimin per tu kthyer ne norma per punonjesit dhe te perfshihen ne materialet promocioonale, disa perfundime mund te arrihen qe ne kete faze.

Ne pasqyren e meposhtme po japim te dhenat mbi kohen qe nevojitet per trajtimin e dokumentave te paraqitura nga qytetaret e ndryshem. Ne kete kohezgjatje perfshihen te gjitha procedurat neper te cilat kalojne keto dokumente sipas llojit te aplikimit qe kryhet, deri ne kthimin e pergjigjes qytetarit.

Nr.	EMERTIMI i APLIKIMIT	KOHEZGJATJA E APLIKIMIT DERI NE DOREZIM
1	Leshimi i certifikatave, dublikatave dhe vertetimeve	45 min
2	Kerkese per ndryshimin e llojit te pasurise, saktesimit te siperfaqies dhe pershkrimtit te pasurise.	45 min
3	Kerkese per regjistrimin e pasurise, kalimet e pronesise dhe heqja dore nga pasuria.	50 min
4	Kerkese per regjistrimin e pjestimit, ndarjes, bashkimit, kembimit te pasurive te paluajtshme, saktesimi i kufijve si dhe veprime te tjera qe sjellin ndryshime ne harten treguese.	60 min
5	Kerkese per regjistrimin e ndryshimit te emrit, saktesimit te emrit, ndryshimin e perfaqsesit te familjes bujqesore dhe adresen e pronarit.	25 min
6	Kerkese per regjistrimin e qerave, ne perdorim, marrveshjeve kufizuese, servitute dhe interesa te tjera, fshirja e tyre.	25 min
7	Kerkese per regjistrimin e hipotekave, vendimeve te gjykates, kufizimeve, fshirja e tyre.	25 min
8	Kerkese per konsultim te karteles dhe te dhena te tjera, per kontrollin zyrtar te regjistrimit te pasurive te paluajtshme, per pregatitjen e dokumentave per Gjykate ose organ tjeter administrativ, fotokopje te dokumentave te Pasurive te Paluajtshme.	90 min
9	Kerkese per korrigjimin e gabimeve materiale ne karteles, e gabimeve teknike ne harte dhe kerkesa per pezullim veprimesh.	45 min

Lidhur me afatet e mesiperme jemi bazuar ne te dhenat e marra nga te dy sektoret e Zyres se Regjistrimit Tirana 1, nisur nga fakti qe ka numrin me te madh te aplikimeve ne shkalle Republike. Gjithashtu u interesuam edhe per fluksin e aplikimeve qe priten ne dite, ku nga perlllogaritjet e bera doli se kemi nje numer mesatar prej 110 aplikime ne dite.

Pas perlllogaritjeve rezulton qe menjehere mund te vihen tepakten norma per kohen e zgjatjes se procedurave te regjistrimit te aplikimit deri ne kthimin e pergjigjes qytetarit, duke marre parasysh edhe numrin e veprimeve per cdo aplikim. Ajo nuk duhet te jete me shume se 2 (dy) dite per pronat e futura ne sistem, ndersa per ato prona qe akoma nuk jane futur ne sistem, kjo peridudhe nuk duhet te jete me shume se 7 (shtate) dite.

Lidhur me te drejten e ankimit te qytetarit ne rastet e thyerjes se afatit, mund te themi se aplikanti ka te drejte te ankohet prane regjistruesisit te Zyres perkatese te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme gjate orarit te pritjes. Ne rast te kundert kur qytetari nuk gjen zgjidhje, atehere ai ka te drejte te ankohet prane Zyres Qendrore, e cila te kete te drejten qe te

kerkoje sqarime nga zyra perkatese dhe te vendose masa disiplinore per personat pergjegjes, gjithashtu te detyroj keta persona per zhdentimin e qytetareve ne lidhje me kohen e harxhuar dhe shpenzimet e kryera prej tij. Ngritja e zyres per marrdheniet me publikun dhe informacionit do ta institucionalizonte kete marredhenie qe deri me sot kryhet ne rruge marredheniesh.

9. J Investimet

Implementimi i Biznes Planit ambicionz te nje institucioni te tille te rendesishem kerkon investime te konsiderueshem. Per kete faze investimet e vogla dhe ato qe lidhen me mirembajtjen e sistemit perballohen nga vete AKRPP dhe jane te pasqyruara ne planin financiar. Pjesa tjeter do te plotesohet me investime nga Buxheti i shtetit dhe nga financime te institucioneve nderkombetare.

Objeket kryesore, te cilat jane te paperseriteshme dhe qe duhet te financohen jane:

- Zgjerimi e rikonstruksioni i kapaciteteve akomoduese dhe i paisjeve perkatese.
- Krijimi i rrjetit informatik rajonal dhe kombetar.
- Rritja e shkalles se informatizimit te zyrave egzistuese.
- Kalimi ne administrim te AKRPP te zyrave egzistuese qe deri me sot jane ne administrim te subjekteve te tjere publike me te cilet ndahen ndertesat perkatese.

Per parashikimin e planit te investime jane kryer perlllogaritjet dhe bilanci i kapaciteteve akomoduese per te gjithë rrethet:

Nr.	RRETHET	SIPERFAQIA NE m ²		
		NEVOJAT	GJENDJA	KERKESA
1	Berat	520	200	320
2	Bulqize	90	132	0
3	Devoll	115	115	0
4	Diber	308	308	0
5	Durres	475	125	350
6	Elbasan	587	178	409
7	Fier	570	250	320
8	Gramsh	106	106	0
9	Gjirokaster	200	125	75
10	Kavaje	260	127	133
11	Kolonje	283	283	0
12	Korce	480	170	310
13	Kruje	200	200	0
14	Kucove	110	0	110
15	Kukes-Has	200	200	0
16	Lac	160	160	0
17	Lezhe	210	139	71
18	Librazhd	328	328	0
19	Lushnje	390	122	268
20	Malesi e Madhe	115	0	115
21	Mallakaster	110	137	0
22	Mat	240	182	58
23	Mirdite	160	213	0
24	Peqin	110	57	53
25	Permet	154	154	0
26	Pogradec	230	175	55
27	Puke	150	115	35
28	Sarande-Delvin	260	260	0
29	Skrapar	150	150	0
30	Shkoder	760	85	675
31	Tepelene	110	110	0
32	Tirane	900	900	0
33	Tropoje	150	180	0
34	Vlore	480	183	297
35	Zyra Qendrore	1.800	0	1.800
SHUMA TOTALE		11.471	6.059	5.564

Investimet per zyrat rajonale konsistojne ne nevojat per ambjente, paisjet akomoduese dhe paisjet e punes. Me poshte po japim tabelen e llogaritjeve te nevojave per nje Zyre Rajonale sipas zerave perkates.

Nr.	ZERI i INVESTIMIT	VLEFTA NE \$
1	NDERTIMI i KONSTRUKSIONIT TE ZYRES (MESATARISHT ESHTË LLOGARITUR NJE SIPERFAQIE AKOMODUESE RRETH 90m ² ME CMIM NJESI 210\$/m ²)	18.900
2	PAISJE ZYRE (10 TAVOLINA PUNE, 15 KARRIKE, 5 DOLLAP + ETAZHER, 15 RAFTE ARSHIVE, ETJ)	7.925
3	PAISJE PUNE (6 KOMPJUTER+UPS, 4 PRINTERA, 1 SERVER+UPS, 1 SKANER, ETJ)	39.000
TOTALI PER NJE ZYRE RAJONALE		65.825

Per sa i perket cmimeve njesi i jam referuar preventivit te hartuar nga Njesia e Menaxhimit te Projektit mbi akomodimin e Zyres Qendrore. Duke i'u referuar pasqyres se mesiperme mund te llogarisim vleren e investimit per te gjitha Zyrat Rajonale. Keshtu per te 9 Zyrat Rajonale te parashikuara ne studim do te kishim nje vlere investimi rreth \$592.425. Nisur nga kjo vlere investimi del e nevojshme te diskutohet ne lidhje me gjetjen e burimit te financimit.

Gjate viteve 2001-2003 eshte menduar per siperfaqje shtese te Zyrave te Regjistrimit, per te cilen kerkohet \$1 527 000 (216 834 000 leke).

Per hapjen dhe funksionimin e Zyrave Rajonale eshte parashikuar investim ne vlere \$592 425 (84124 350 leke). Vlera e investimeve per rehabilitimin e zyrave dhe ngritjen e rajoneve eshte menduar te **financohet nga Buxheti i Shtetit**. Ne tota kjo vlere eshte \$2 119 425 (300 958 350 leke)

Per investimet e **sistemit te informacionit ne shkalle kombetare dhe rajonale** si dhe networkut per grumbullimin dhe sintetizimin e informacionit *eshte menduar per tu financuar nga Banka Boterore rreth \$1 000 000 (142 000 000 leke)*

9. K Teknologjia e informacionit.


SISTEMI i INFORMACIONIT SOT DHE NE TE ARDHMEN

Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme mund te konsiderohet si nje sistem qe "prodhon informacion". Kjo nenkupton, organizimin e sistemit ne nje menyre te tille, qe ai te jete i afte te administroje te gjithe informacionin dhe kjo do te thote ruajtje sa me efikase; perdorim sa me te lehte; kerkim sa me te shpejte. Realizimi i ketyre kerkesave kerkon

Nje organizim administrativ “te persosur”.

Sistemi i pasurive te paluajtehme do te grupohet ne zyra te tre niveleve:

1. **Zyra Qendrore**
2. **Zyra Rajonale**
3. **Zyra Lokale**



Kjo eshte skema , qe do te lejoje nje “rrjedhje” sa me efektive te informacionit nga nje “burim” ne tjetrin nepermjet nje “kanali”, ku humbjet pergjate tij te konsiderohen *zero*. Per kete qellim ajo qe duhet te konsiderohet primare eshte funksionimi perfekt i zyres ku grumbullohet dhe perpunohet infomacioni: **Zyres Lokale**. Eshte kjo zyre, çelisi primar, qe hap dyert e nje komunikimi sa me korrekt mdis zyrave te niveleve me larta, qe do te sherbejne thjesht si hallka drejtimi te nje funksionimi normal te zyres lokale. Po si eshte i organizuar sot informacioni statistikor dhe kontabel ne zyrat e regjistrimit ne rrethe dhe si behet kalimi i ketij nformacioni ne zyren qendrore?

1. Sistemi i informacionit sot

Te gjitha rrethet pergatisin informacionet statistikore me dore. Aktualisht te gjitha statistikat e derguara prane zyres qendrore jane **te unifikuara vetem** ne formatet ne te cilat ato dergohen. Çdo rreth pergatit evidencat statistikore apo financiare ne menyre krejt te pavarur, ne kuptimin qe nuk ka asnje kontroll mbi te dhenat qe permbajne keto evidenca. i vetmi kontroll qe realizohet psh ne evidencat financiare eshte akordimi me thesarin, dmth shuma totale e te ardhuarve apo shpenzimeve per çdo rreth. Persa i perket kontrollit te zerave te veçante kjo gje eshte praktikisht e pamundur. Gjithashtu eshte praktikisht e pamundur qe ashtu siç sillen evidencat te mund te analizosh zera te vecante per t’i krahasuar me periudha paraardhese.

Me pak fjale nuk ekziston nje sistem i unifikuar qe te jete ne gjendje te analizoje dhe te kontrolloje te gjitha evidencat e pergatituar neper rrethe.

2. Sistemi i informacionit ne te ardhmen

Nga pikepamja organizative mendohet te ndyshoje organizimi i punes. Do te shtohet nje hallke tjetër midis Zyres Qendrore dhe zyrave te regjistrimit ne rrethe, qe do te jete Zyra Rajonale. Çfare do te permiresoje zyra rajonale ne lidhje me evidenact statistikore?

- Do te beje nje filtrim te informacionit, duke zgjedhur informacionin me te “rendesishem” qe duhet te dergohet prane zyres qendrore.
- Duke qene se nje zyre rajonale do te perfshije nje numer te kufizuar rrethesh (deri ne 6 rrethe) ajo do te jete ne gjendje te kontrolloje infromaconet statistikore apo financiare, perpara se ato te marrin forme perfundimtare.
- Zyrat rajonale nepermjet struktures moderne informatike qe mendohet te ngrihet do te jete e afte te kete nen kontroll gjithcka qe ndodh neper zyrat e rretheve qe ajo qo te kete nen varesi. Kjo do te thote qe informacioni qe do te grumbullohet prane ketyre

zyrave, do te kontrollohet, do te filtrohet, ndoshta do te ristrukturohet dhe vetem nje pasqyre apo evidence permbledhese do te kaloje ne zyren qendrore.

Nga pikepamja e menyres se si do te percillet informacioni nga nje nivel zyre ne tjetrin eshte menduar:

Per shkak te

- koston shume te larte qe mund te kete shtrirja e nje rrjeti kompjuterik ne te gjitha vendin.
- afersise gjeografike midis zyrave rajonale dhe zyrave te regjistrimit ne rrethe.
- mosstabilizimit te vendit me energji elektrike dhe pamundesise per blerjen e gjenitoreve ne te gjitha zyrat.
- Sasise se paket te informacionit nga rrethet e “vogla”, te cilat do te jene ne varesi te nje zyre rajonale e ngritur ne rrethet qe sigurojne nje volum te madh pune dhe si rrjedhoje edhe nje sasi te madhe informacioni etj

Nuk do te ngrihet rrjet kompjuterik qe do te lidhe zyrat rajonale me zyrat e regjistrimit neper rrethe. Informacioni nga zyrat e regjistrimit ne zyrat rajonale do te percillet ne format leter dhe ne disketa.

Per shkak te

- Sasise se madhe te informacionit qe do te percillet nga zyrat rajonale ne zyren qendrore.
- Mundesise se stabilizimit me energji elektrike me ane te gjeneratoreve te 9 zyrave rajonale dhe zyres qendrore, qe do te thote furnizim i vazhdueshem me energji elektrike.
- Kerkeses per te patur nje informacion te shpejte dhe te azhornuar ne çdo moment kohe.
- Kontrollit qe do te kryhet nga zyra qendrore ne informacionin e grumbulluar ne zyrat rajonale etj

parashikohet te ngrihet nje rrjet kompjuterik qe do te lidhe zyren qendrore te regjistrimit te pasurive te paluajtshme me zyrat rajonale. Kjo do te thote qe i gjithë informacioni statistikor, financiar etj do te merret direkt nga zyra qendrore nepermjet rrjetit kompjuterik. Por cila eshte teknologjia hardware dhe software qe do te beje te mundur realizimin e kesaj strategjie?

- ***Pajisjet hardware***

Pajisjet qe ekzistojne tashme neper zyrat e regjistrimit jane te nje teknologjie mjaft te vjeter. Duhet te mendohet nje zevendesim total i ketyre pajisjeve si edhe nje shtim ne numer dhe lloje te pajisjeve kompjuterike. Ekziston nje plan i detajuar ne lidhje me numrin dhe llojin e pajisjeve qe eshte menduar te shperndahet ne zyrat lokale, rajonale dhe zyren qendrore. Por per kete kerkohet ndoshta nje studim i mevonshem.

- *Pajisjet software*

Nqs kerkojme te punojme ne nje mjedis rrjeti, atehere te gjitha programet software duhet te ndertohen te tilla qe te jene te aplikueshme ne nje mjedis te tille. Kjo kerkon krijimin e nje baze te dhenash relacionale (dmth e modifikueshme ne nje mjedis rrjeti) dhe ndertimin e nje softwari i aplikueshem mbi kete baze te dhenash. Si rrjedhim per te gjitha evidencat qe do te grumbullohen prane zyres qendrore duhet te krijohet nje baze te dhenash qendrore e cila do te azhurnohet automatikisht nga informacioni qe zyrat rajonale do te dergojne ne zyren qendrore.

Teknologjia e informacionit te AKRPP.

- Informacioni qe kalon permes sistemit te regjistrimit (informacioni qe del apo hyn ne kete sistem), institucionet me te cilat sistemi shkemben informacion, procedurat e dhenies/marrjes se informacionit.
- Procedurat per krijimin, ruajtjen dhe azhurnimin e arkivave manule dhe dixhitale
- Menytrat e futjes se teknologjise se informacionit (sistemi i operimit, baza e te dhenave, rrjetet lokale dhe kombetare, pajisjet hardware dhe software).

HALLKAT KRYESORE TE SISTEMIT TE REGJISTRIMIT

Zyrat e Sistemit

(te dhenat qe kane te bejne me teknologjine e informacionit)

- Berja dhe Mirembajtja e Hartave Kadastrale
- Identifikimi dhe Pershkrimi i Pasurive te Paluajtshme
- Percaktimi i Politikave te Ndryshme.
- Mirembajtja dhe Perhapja e Informacioneve te ndryshme mbi Pasurite e Paluajtshme
- Menytrat e azhurnimit te arshivave dixhitale dhe fizike.
- Regjistrimet e dokumentave ligjore te pergatitura nga noteret
- Azhurnimet mbi hartat bazuar ne dokumenta te pergatitura nga inxhinieret topograf
- Lidhja midis te dhenave alafanumerike mbi pronen, te dhenave grafike me harten perkatese dhe imazheve te dokumenteve ligjore apo teknik.

Perdoruesit

- Individet
- Dhoma e Notereve
- Bankat
- Instituti i Tokes
- Kompanite Real Estate
- ...
- ...
- Institucione te Ndryshme Private apo Publike

Teknologjia

- Integrimi i Hardware, Software dhe Networkut
- Manaxhimi i bazes se te dhenave grafike, imazheve dhe te dhenave alfa – numerike
- Asistenca Teknike, Trajnime
- Consultimet

Teknologjia e informacionit.

SOT ekziston nje teknologji e prapambetur ne rrethe. Ne keto zyra ekziston 1 ose 2 kompjutera me parametra te vjeter teknik.

Teknologjia e informacionit qe do te sherbeje si baze e punes ditore ne zyrat e regjistrimit kerkon nje personel me te kualifikuar persa i perket njohurive ne teknologjine e informacionit. Stafi i sotem me te cilet operojne zyrat e regjistrimit kane nje nivel kualifikimi mjaft te ulet ne kete drejtim

Sistemi software i pergjigjet bazes se te dhenave te ngritur nga NMP ne nje format ACCESS.

Zyra e regjistrimit ku perballen te gjitha problemet qe ndesh sot Sistemi i Regjistrimit eshte Tirana 1, prandaj kjo zyre do te jete zyra pilot per venien ne zbatim te projekteve te informatizimit. Gjithashtu kjo do jete zyra e pare ku do te realizohet ngritja e nje rrjeti midis Zyres se Regjistrimit dhe Zyres Qendrore.

Sistemi do te ngrihet i mbeshtetur plotesisht ne teknologjine klient – server.

Sistemi i Operimit

UNIX, SCO UNIX per server
WINDOWS 95/98/2000 per klientet

Baza e te dhenave

RELACIONALE, jane bazat e te dhenave qe mbeshtetin programimin ne rrjet.

Rrjetet Lokale

Rrjetet lokale do te ngrihen ne zyrat rajonale dhe Zyren Qendrore. Ne baze te strukturave perkatese, parashikohet qe te jene rreth (...) poste pune.

Rrjeti Kombetar

Do te ngrihet midis Zyrave Rajonale dhe Zyres Qendrore. Ngritja e nje rrjeti kombetar ka dy faza te rendesishme:

- Ngritjen e nje rrjeti lokal, i cili do te funksionoj ne te gjitha zyrat rajonale, ne Zyren Qendrore dhe ndoshta ne disa zyra lokale (ndoshta ne te gjitha).
- Lidhja ne rrjet e niveleve te ndryshme te zyrave ne Sistemin e RPP.

Pajisjet Hardware

Do te mbeshteten kryesisht: nje **Server** per cdo Zyre Rajonale dhe Zyren Qendrore, **Kompiuter** (eshte percaktuar afersisht numri i kompjuterave ne projektin derguar Bankes Boterore), Printer etj

Pajisjet Software

Hedhja dhe manaxhimi i informacionit te kartelave, hartave, Dokumentave Ligjore/ Teknike, lidhja midis Arkives dixhitale te Kartelave, Hartave dhe Imazheve te dokumentave, hedhja, kontrolli dhe manaxhimi i te dhenave kontable, nxjerrja ne menyra te automatizuar e bilanceve, perpunimi i statistikave ekonomiko - financiare, regjistrimi i te gjithe punonjesve te sistemit shoqeruar me detyren, kualifikimin, vjetersine, zyren perkatese, pagat etj si edhe statistika te ndryshme ne lidhje me punonjesit etj.

Asistenca Teknike

Ka te beje me asistencen e firmave te ndryshme qe do te marrin pjese ne ndertimin e sistemeve hardware apo software. Gjithashtu nje grup njerezish te kualifikuar qe do te grumbullohen prane ZQ do te japin asistencen teknike, trajnime, kurse te ndryshme kualifikimi per te gjithe punonjesit e sistemit.

Trajnime, Konsultimet

Sot praktikohet trajnimet qe behen kryesisht nga ZQ dhe NMP kryesisht per probleme juridike, financiare apo teknike. Me futjen e teknologjise se infomacionit do te percaktohet nje procedure e re trajnimi per punonjesit. Menyrat:

- Marreveshje me Universitet (brenda dhe jashte vendit) per organizime te kurseve me kohezgjatje te ndryshme.
- Marreveshje me institucione te ndryshme (brenda dhe jashte vendit) per njohjen dhe mundesine e futjes se teknologjive te reja ne sistemin tone te regjistrimit.
- Njohja me teknologjine apo sisteme informatizimi te sistemeve te ngjashme (brenda apo jashte vendit)
- Organizime nga ZQ e kurseve per trajnime te punonjesve ne zyrat e regjistrimit apo zyrave rajonale
- ...

ORGANIZIMI i ARSHIVES FIZIKE dhe DIXHITALE

Informacioni qe zoteron sistemi i regjistrimit:

- Mbi pasurite e paluajtshme

- Mbi te dhenat kontabel
- Mbi organizimin administrativ
- Mbi korespodencat e ndryshme me institucione publik/private, individe, persona fizik/juridik.

1. **Mbi pasurite e paluajtshme:**

Eshte informacioni baze mbi te cilen funksionon sistemi. Te gjitha te dhenat e tjera, jane rrjedhim i ketij informacioni. Si jane ndertuar sot keto te dhena:

Informacioni i Regjistrave te hipotekes

Informacioni i Kartelave

Informacioni i Hartave

Informacioni i Dokumentave

- **Sistemi i Hipotekes**

SOT i tere ky sistem funksionon ne menyre manuale. Arshiva fizike e gjendur eshte mjaft e demtuar dhe e papershtatshme per te nxjerre te dhena te ndryshme. Ekzistojne regjistrat qe nga viti 1917.

Ka filluar procesi i informatizimit te sistemit te hipotekes. Eshte llogaritur rreth 100.000 USD kostoja e ketij procesi per zyren e regjistrimit te pasurive te paluajtshme Tirana 1. Duke patur parasysh se ne keto kosto perfshihen programi per hedhjen dhe korrektimin e te dhenave, ai i shfrytzezimit te te dhenave si edhe procesi i hedhjes se ketyre te dhenave, parashikohet se kostoja e ketij procesi per te gjitha zyrat e regjistrimit do te jete rreth 10 here me e madhe. Informatizimi i sistemit te hipotekes do te krijojte nje arshive dixhitale, e cila do te sherbeje per nje ruajtje te sigurte dhe manaxhim perfekt te informacionit qe permbajne librat e hipotekes.

- **Sistemi i Kartelave.**

SOT ky sistem eshte ne proces te informatizimit. Per te gjitha kartelat eshte krijuar baza e te dhenave dixhitale.

Megjithe punen mjaft te madhe te realizuar nga NMP ka vend per korigjime. Ka pasaktesira ne bazen e te dhenave midis karteles fizike dhe asaj dixhitale, nuk jane bere ende azhornimet dhe me e rendesishmja baza e te dhenave te krijuar nuk suporton shfrytezimin ne rrjet te saj. Duhet te parashikohet nje kosto e eksportimit te te gjitha bazes se te dhenave ne nje baze te dhenash relacionale. Programi per manaxhimin, azhornimin e kartelave duhet te mbeshitet ne nje baze te dhenash relacionale. Termat e references per kete program do te pergatiten nga Zyra Qendrore ne bashkepunim me NMP.

- **Sistemi i hartave**

SOT jane krijuar hartat e reja me te cilat punojne zyrat e regjistrimit. Eshte krijuar nje arshive me skicat origjinale te ketyre hartave, te cilat ndodhen prane zyrave ne rrethe. Nuk ka asnje harte origjinale prane Zyres Qendrore, dhe prane NMP eshte krijuar

arshiva dixhitale. Nuk eshte testuar ende realizimi i lidhjes se karteles me harten persa i perket arshives dixhitale te tyre.

E rendesishme eshte krijimi prane Zyres Qendrore i arshives fizike te hartave origjinale, sic kane qene ato ne momentin e pare te regjistrimit fillestar. Testimi i arshives dixhitale te krijuar, persa i perket gabimeve dhe lidhjes qe eshte bere me arkiven dixhitale te kartelave.

-Sistemi i Dokumentave

SOT per dokumentat ekziston arshiva fizike, e organizuar sipas numrit te hipotekes, per pasurite qe vazhdojne te punojne me sistemin e hipotekes, dhe per pasurite qe i perkasin periudhes para vitit 1990 dhe ne baze te numrit te references per pasurite e paluajtshme qe sot punojne me sistemin e ri te regjistrimit.

Arshiva fizike e dokumentave ligjore apo teknike do te shoqerohet se shpejti me arshiven dixhitale te tyre. Kjo arshive do te krijohet ne baze te skanimit te ketyre dokumentave. Ky projekt do te realizohet ne dy faza:

- *Skanimi i dokumentave te arshivuara ne vite prane sistemit te regjistrimit*
- *Skanimi i dokumentave qe hyjne cdo dite ne sportelet e zyrave te regjistrimit*

Ky projekt ka dy faza te rendesishme:

Percaktimi i procedurave te skanimit te dokumentave qe perfshin programet perkatese per realizimin, shfrytezimin dhe lidhjen me kartelat perkatese te imazhit te dokumenatve; procedura ditore e menyres se skanimit, azhornimit te arshives dixhitale, krijimi i back-up per kete arshive.

Percaktimi i llojeve te dokumentave per te cilat do te krijohet arshiva dixhitale. Sic dihet eshte nje numer i konsiderueshem dokumentash qe pranohen ne kryerjen e nje veprimi, dhe ky numer ndryshon ne varesi te llojit te veprimit. Per kete problem duhet te ngrihet nje grup pune midis sektorit tekniko – ligjor dhe atij te informatikes, perpara se te percaktohen me tej nga sektori i informatikes hapat e metejshem per kete projekt.

STATISTIKAT

- | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none">- Ekonomiko – Financiare
korespondence me Ministrine e Financave dhe Deget e Thesarit- Mbi numrin e Punonjesve dhe Fondin e Pagave
korespondence me Institutin e Statistikes- Mbi transaksionet e Kalimit te Pronesise ne zonat urbane dhe rurale
korespondence me NMP... |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

1. Ekonomiko – Financiare dergohen nje here ne muaj prane zyres qendrore dhe pergatiten nga financieret e zyrave te regjistrimit

- Statistikat mbi te ardhurat primare/dytesore
- Statistikat mbi shpenzimet

Statistikat mbi te ardhurat primare permbajne te dhena per llojin e veprimeve te cilat perfshijne

- Numrin
- Tarifate perkatese dhe te ardhurat per cdo veprim te kryer sipas rrethit
- Te ardhurat totale sipas rretheve
- Te ardhurat totale sipas llojit te veprimit te kryer
- Te ardhurat totale

Te dhenat per realizimin e ketyre statistikave merren ne menyre manuale nga aplikimet e prera, kopja qe ruhet ne arke ne momentin e kryerjes se pageses. Menyra e leximit eshte hapja e aplikimeve nje nga nje duke evidentuar llojin e veprimit, tarifen, gjoben per dite vonese dhe pagesa totale.

Statistikat mbi te ardhurat dytesore permbajne te ardhurat qe realizohen kryesisht nga gjobat dhe shitja e hartave te realizuara nga zyrtaret e regjistrimit.

Statistikat mbi shpenzimet perfshijne shpenzimet te bera nga zyrtaret e regjistrimit, perfshire edhe zyren qendrore) te ndara sipas te gjithave zerave te percaktuar. Te dhenat per shpenzimet nxirren nga ditari i shpenzimeve i mbajtur nga financieret per cdo zyrtar regjistrimi.

Zyra qendrore pasi grumbullon keto statistika ben akordimet perkatese me Ministrine e Financave per te ardhurat ne total, si dhe me zyrtaret e thesarit per shpenzimet. Zyra qendrore realizon nje table permbledhese te te gjitha te ardhurave dhe shpenzimeve, perpara se ajo te beje akordimet perkatese.

Duke patur parasysh menyren dhe vendin nga merren te dhenat per te realizuar statistikat, do te duhen dy programe per te realizuar keto statistika:

1. Programi i transaksioneve
2. Programi per hedhjen dhe shfrytezimin e te dhenave kontabel

Programi i transaksioneve i cili do te realizohet ne rradhe te pare per hedhjen, azhornimin dhe manaxhimin e te dhenave qe i perkasin ndryshimeve ne pasurite e paluajtshme, do te perfshije edhe nje analize financiare te llojeve te veprimeve qe behen. Kjo do te thote qe per cdo veprim qe regjistrohet me ane te programit do te shenohet edhe tarifa perkatese e ketij veprimit (shoqeruar edhe me gjoben ne rastet e vonesave ne regjistrimin e kontratave te ndryshme apo vendimeve gjyqesore). Ky program do te jete i afte te nxjerre ne menyre automatike te dhenat statistikore te llojeve te veprimeve (numri dhe tarifa perkatese) qe behen sot ne menyre manuale nga zyrtaret e regjistrimit. Ajo qe duhet shqyrtuar dhe menduar eshte menyra se si do te percillen keto te dhena ne zyren qendrore duke patur parasysh edhe ngritjen e zyrtareve rajonale. Menyra e percjelljes se ketyre evidencave statistikore do te shqyrtohet e lidhur ngushte me menyren se si do te azhrohohet ne teresi baza e te dhenave nga rrethet dhe se si ajo do te grumbullohet prane

zyrave rajonale dhe me vone ne zyren qendrore. (do te percaktohet nderkohe kjo procedure)

Programi per hedhjen dhe shfrytezimin e te dhenave kontabel do te behet ne baze te parimeve baze me te cilat punojne sot zyrat e regjistrimit. Aktualisht sot ekziston nje program kumpjuterik i instaluar prane zyres qendrore qe realizon nxjerrjen e bilancit dhe manaxhimin e magazines. Ky program punon ne nje kompjuter te vetem, jo i aplikueshem ne nje mjedis rrjeti per shkak te formatit te bazes se te dhenave. Ka dy mundesi:

Instalimi i ketij programi neper zyrat e regjistrimit

E mira: koha e shkurter e realizmit

E keqja: krijimi i nje baze te dhenash jo i aplikueshem ne rrjet, jo i pershtatshem per strategjine me te fundit teknologjike ku mendohet te gjeje veten sistemi ne nje te ardhme jo te larget.

Realizimi i nje programi te ri kompjuterik per te dhenat kontabel

E mira: krijimi i nje baze te dhenash i aplikueshem ne rrjet, dhe ndertimi i ketij programi sipas specifikave qe i kerokon sistemi.

E mira: koha e me gjate e realizmit te tij.

Te dy menyrat kane nje kosto pothuajse te njejte te realizmit te tyre. Avantazhi qe te jep menyra e dyte eshte e dukshme.

- 2. Mbi numrin e punonjesve dhe fondin e pagave** dergohen nje here ne tre muaj prane zyres qendrore dhe pergatiten nga financieret e zyrave te regjistrimit. Ato permbajne te dhena mbi numrin e punonjesve, kategorine perkatese te tyre si edhe te dhena mbi fondin e pagave gjithsej dhe te specifikuar sipas pozicionit qe kane punonjesit ne pune.

Menyra e pergatitjes se tyre eshte ne menyre manuale.

Ne zyren qendrore duhet te ngrihet nje baze te dhenash qe te permbaje informacionin per te gjitha punonjesit e sistemit te regjistrimit. Te dhenat qe do te regjistroheshen per cdo punonjes, do te bejne te mundur nxjerrjen e te dhenave statistikore direkt nga zyra qendrore (psh te dhenat mbi numrin e punonjesve, pozicioni qe ata kane ne sistem). Por nuk mund te percaktohet direkt ne zyren qendrore te dhenat mbi fondin e pagave, statistike sot qe percillet ne zyren qendrore nga zyrat e regjistrimit ne rrethe. *Duhet shikuar menyra e plotesimit te fushave te te dhenave mbi fondin e pagave, kompensimet, sigurimet per te percaktuar nje procedure te plote te realizimit te statistikave mbi numrin e punonjesve dhe fonfin e pagave.*

- 3. Mbi transaksionet e kalimit te pronesise ne zonat urbane dhe rurale** degohen nje here ne muaj prane zyres Qendrore dhe pergatiten nga inxhinieret hartograf prane zyrave te regjistrimit ne rrethe. Permbajne te dhena per llojin e pasurise, mbi te cilin eshte kryer kalimi i pronesise, siperfaqen, vleren e transaksionit si edhe nje tablele per cmimin ne m².

Te dhenat per realizimin e ketyre statistikave merren ne menyre manuale nga aplikimet e prera. Menyra e leximit eshte hapja e aplikimeve nje nga nje duke evidentuar llojin e veprimit midis te gjitha veprimeve te tjera te kryera ne keto zyra.

Programi i transaksioneve i cili do te realizohet per hedhjen, azhornimin dhe manaxhimin e te dhenave qe i perkasin ndryshimeve ne pasurite e paluajtshme, do te beje te mundur realizimin e shume statistikave te rendesishme, dhe statistikave te mesiperme do te jene nje nga to. Nqs mendohet per grumbullim te te gjitha bazes se te dhenave prane zyres qendrore, atehere nxjerrja e ketyre statistikave eshte plotesisht e realizueshme te behet nga vete punonjesit e zyres qendrore.

Te gjitha statistikave qe duhen te nxirren nga programi i transaksioneve duhet te perbejne nje ide te qarte per menyren e pergatitjes se termave te references.

Insitucionet qe kane lidhje me sistemin e regjistrimit

Te dhenat ne sistemin e regjistrimit te pasurivete paluajtshme do te jene kopjen e tyre manuale dhe dixhitale. Administrimi i tyre kerkon ne cdo kohe perputhje te plote te ketyre arshivave dhe nxjerrjen e te dhena qe kerkohen ne nje kohe reale, ne cdo moment dhe ne cfaredo lloj formati. Nqs sot ekziston ne nje menyre me te plote arshiva fizike, administrimi i saj eshte disi i veshtire. Arshiva dixhitale qe do te krijohet dhe administrohet vetem nga Sistemi i Regjistrimit ka per qellim kryesor:

- Krijimin e nje kopje te arshives fizike me qellim ruajtjen e kesaj te fundit ne rast te ndonje demtimi.
- Administrimin ne nje kohe reale te dhenave qe ka te beje me nxjerrjen e ndryshme te statistikave ne nje kohe sa me te shpejte.
- Sherbim te shpejte me klientet dhe perdorimi i informacionit te grumbulluar ne dobi te perdoruesve te ndryshem.

PROJEKT - RREGULLORE PER KRIJIMIN, RUAJTJEN DHE AZHORNIMIN E ARSHIVES DIXHITALE.

Te dhena te pergjithshme mbi Arshiven Dixhitale

1. Arshiva dixhitale perbehet nga i gjitha informacioni qe zoteron sistemi i regjistrimit perfshire ketu informacionin mbi librat e hipotekes, kartelat, hartat, dokumentat e ndryshme, lidhjet midis arshives dixhitale te seciles prej tyre, korespondencat e ndryshme.
2. Te gjitha proceset DATA ENTRY qe realizohen per Zyren Qendrore i shtohen arshives dixhitale. Kompanite qe realizojne proceset e ndryshme Data Enter nuk kane te drejte te perdorin informacionin e hedhur. Informacioni dixhital pas perfundimit te procesit te hedhjes konsiderohet prone e sistemit te regjistrimit.
3. Format i bazes se te dhenave dhe sistemi software i perdorur duhet t'i pergjigjen ne cdo kohe kerkesave te sistemit me qellim manaxhimin sa me te mire te te dhenave qe zoterohen.
4. Cdo veprim qe kryhet mbi sistemin dixhital te te dhenave si: konvertimi i te dhenave ne nje format me te mire, ndryshime ne strukturen e pergjithshme te sistemit te

informacionit, ndryshime ne sistemin software etj kryhet me autorizim nga Kryeregjistruesi.

5. Arshiva dixhitale konsiderohet nje informacion i sigurise se larte per sistemin e regjistrimit, prandaj duhet t'i nenshtrohet te gjitha kerkesave qe kane te bejne me nje informacion te tille si menytrat e ruajtjes, personat pergjegjes, menyra e administrimit, shitja e tij etj.

Ruajtja e arshives dixhitale

1. Arshiva dixhitale do te ruhet ne dy kopje. Te dy kopjet ne duhet te jene identike ne momentin e unifikimit te tyre.
2. Te dy kopjet e arshives dixhitale do te ruhen ne ambientet e Zyres Qendrore te Regjistrimit te PP. Ambientet e ruajtjes se arshives dixhitale duhet te plotesojne te gjitha kushtet per nje ruajtje sa me normale, kushte qe kane te bejne kryesisht me temperaturen e ambientit, lageshtine, mbrojtjen kundra zjarrit etj.
3. Te dy kopjet e arshives dixhitale ruhen ne dy SERVERA te ndryshem brenda ambienteve te Zyres Qendrore, njeri prej te cileve do te sherbeje si Back Up i arshives dixhitale.
4. Ne varesi te volumit qe krijohet dhe rendesise mjaft te madhe qe ka informacioni, me autorizim nga Kryeregjistruesi krijohet edhe nje kopje e trete e arshives dixhitale, qe ruhet jashte ambienteve te Sistemit te Regjistrimit. Ambienti i jashtem duhet te plotesoje te gjitha kushtet normale per nje ruajtje sa me te mire te arshives dixhitale.
5. Personat pergjegjes per ruajtjen e arshives dixhitale caktohen nga Kryeregjistruesi dhe mbajne pergjegjesi per demtimin e saj.
6. Personat pergjegjes qe caktohen per ruajtjen e arshives dixhitale brenda dhe jashte sistemit te regjistrimit nuk kane te drejte te japin informacion ne lidhje me te dhenat qe permban arshiva qe ata kane ne ruajtje.
7. Personat e caktuar per ruajtjen e arshives dixhitale mbajne pergjegjesi per cdo demtim apo asgjesim te saj ne kushtet e nje ruajtje normale.

Perdorimi, Azhornimi dhe Nxjerrja e Statistikave te Ndryshme nga Arshiva Dixhitale.

1. Te gjitha veprimet mbi bazen e te dhenave do te realizohen nga punonjesit e zyrave te regjistrimit. Asnje individ tjetër, brenda dhe jashte sistemit te regjistrimit te pasurive nuk ka te drejte te kryeje veprime qe shoqerohen me ndryshime ne bazen e te dhenave.
2. Te dhenat statistikore printohen vetem nga persona te autorizuar. Te gjitha te dhenat statistikore qe shprehin marredhenie midis Sistemit te Regjistrimit dhe institucioneve te tjera publik apo private behen me urdher te Kryeregjistruesit, dhe percillen vetem ne firmen e tij. Te dhenat per efekt studimi brenda sistemit te regjistrimit printohen nga baza e te dhenave nga vete personat e interesuar brenda sistemit, me asistencen e informaticienit.
3. Pervec personave te autorizuar asnje individ tjetër, punonjes ose jo i sistemit te regjistrimit nuk ka te drejte te jape informacion gojor apo te shkruajtur mbi te dhenat qe permban arshiva dixhitale.

4. Hierarkia e perdorimit apo ndryshimit te arshives dixhitale percaktohet nga Kryeregjstruesi. Kjo hierarki duhet te percaktohet qarte ne sistemin software qe do te ndertohet per te manaxhuar kete arshive.
5. Perdoruesit e bases se te dhenave e kane te ndaluar te:
 - a. Futen ne rrjet nen nje identitet tjeter.
 - b. Te tentoje te njohe dhe administroje informacion jashte te drejtave qe i jep statusi i tij.
 - c. Te importoje apo te eksportoje te dhena jashte statusit qe i eshte percaktuar ne hierarkine e perdoruesve.
 - d. Te instaloje nje software apo hardware te ri apo te ndryshoje ata ekzistues.
6. Personi pergjegjes per azhornimin e arshives dixhitale duhet te hartoje dhe printoje raporte te ndryshme bazuar ne bazen e te dhenave vetem kur keta raporte kerkohen nga punonjes te ndryshem te autorizuar ose per efekt studimi. Ai duhet te jete i afte te krijojte ne cdo kohe raporte te reja bazuar ne analizat qe i behet informacionit te sistemit te regjistrimit te pasurive te paluajtshme.

Klasifikimi dhe menytrat e shitjes se informacionit

1. Informacioni dixhital apo fizik i ndodhur nen administrimin e Sistemit te Regjistrimit konsiderohet PRONE e sistemit. Sistemi i Regjistrimit eshte burimi i vetem i njohur per te gjithete dhenat qe ai zoteron dhe vetem personat a autorizuar, punonjes te ketij sistemi kane te drejte te japin te dhena te ndryshme ne lidhje me arshiven dixhitale apo fizike. Cdo burim tjeter ne lidhje me kete informacion do te konsiderohet nga sistemi i regjistrimit si shkelje e te drejtave te tij dhe do te ndiqet me rruge gjyqesore.
2. Informacioni do te konsiderohet "I HAPUR" kur vendoset nga Kryeregjstruesi. Ne kete rast ai mund te shikohet edhe perdoret nga cdo individ dhe institucion publik apo shteteror. Gjithashtu cdo individ ka te drejte printimin e ketij informacion dhe shumefishimin e metejshme te tij.
3. Informacioni do te konsiderohet "SEKRET" kur vendoset nga Kryeregjstruesi. Ne kete rast vetem personat e autorizuar nga Kryeregjstruesi ose personat per te cilet ky informacion printohet kane te drejte ta shikojne dhe te kryejne studime te metejshme bazuar ne kete informacion. Por keta persona nuk kane te drejte ta perdorin kete informacion ne menyre te shumefishuar apo per interesa qe bien ndesh me rregullat e sistemit te regjistrimit. Printimi i ketij informacioni behet gjithashtu vetem nga persona te autorizuar.
4. Te gjithete institucionet, publike apo private qe kerkojne te marrin informacion te konsideruar "SEKRET" duhet qe me pare te nenshkruajne nje kontrate me Zyren Qendrore apo Hallkat e tij. Kontrata hartohet nga Zyra Qendrore ne perputhje me kerkesat qe ka institucioni. Modeli dhe forma e kontrates per nje lloj te caktuar informacioni duhet te jete i njejte.
5. Informacioni i konsideruar "Sekret" nuk publikohet ne shtyp, ne buletinet e ndryshme qe nxjerr vete sistemi apo internet.
6. Informacioni i konsideruar "I HAPUR" mund te publikohet ne shtyp, buletinet e ndryshme qe nxjerr vete sistemi apo internet. Te drejten per publikimin e tij e ka dhe e

jep vetem Sistemi i Regjistrimit. Forma, menyra e publikimit te ketij informacioni percaktohet nga Sistemi i regjistrimit.

7. Per te gjithë informacionin “SEKRET” apo “TE HAPUR” percaktohet nga Sistemi i Regjistrimit vlera ne leke e tij. Ne cdo rast shitja e informacionit kryhet ne baze te rregullave te vendosura nga sistemi i regjistrimit.
8. Te gjitha institucionet qe blejne informacionin nuk kane te drejte ta perdorin ate pervecse qellimit te blerjes se tyre, qellim i cili perputhet plotesisht me rregulloren e sistemit te regjistrimit.
9. Forma e dhenies se informacionit te shitur mund te jete fizike apo dixhitale. Ne te dy rastet percaktohet cmimi perkates per secilen nga menytrat e shitjes.
10. Rastet e shitjes se informacionit ne menyre dixhitale apo fizike percaktohen nga zyra qendrore, ne varesi te klasifikimit, volumit dhe rendesise se informacionit qe shitet.

Transferimi i arshives dixhitale midis zyrave te niveleve te ndryshme

1. Zyrat e regjistrimit duhet te transferojne prane zyres rajonale perkatese nje kopje te te gjithë bazes se te dhenave.
2. Perpara pergatitjes se kopjes se bazes se te dhenave pregatitet nje raport mbi permbajtjen e bazes se te dhenave. Raporti pregatitet ne dy kopje dhe firmoset nga personi qe e dorezon dhe ai qe e merr ne dorezim.
3. Menyra e dorezimit te kopjes se arshives dixhitale percaktohet ne varesi te sistemit te informatik te ngritur ne zyrat perkatese. Ai do te behet me diskete ne rastet e nje mungese rrjeti midis Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme zyrave niveleve te ndryshme. Ne rastet kur ekziston rrjeti qe lidh zyrat e niveleve te ndryshme transferimi behet me ane te rrjetit informatik.
4. Rrjeti informatik i ngritur duhet te plotesoje te gjitha kerkesat e nje rrjeti te sigurte per transferimin e informacionit. Ai duhet te jete i mbrojtur nga nderhyrjet e paautorizuara dhe te sinjalizojë ne cdo moment nderhyrjet e paautorizuara ne rrjet nerpemjet elementeve te vecante software.
5. Personeli i cili punon me rrjete informatike duhet te jete i specilaizuar ne fushen e operimit apo shfrytezimit te rrjetit.
6. Administratoret e rrjetit pergjigjen per zbatimin e masave te sigurise se tij dhe per te siguruar nje transmetim normal te te dhenave ne te gjithë rrjetin informatik te ngritur.
7. Baza e te dhenave transferohet ne zyren rajonale perkatese ne menyre periodike, periode e cila percaktohet nga zyra rajonale dhe zyra e regjistrimit perkatese.
8. Percaktimi i periodes behet ne varesi te volumit te punes per zyrat e regjistrimit.
9. Ne asnje rast tjeter, perves atyre te percaktuara me pare nuk behet dorezimi i kopjes se arshives dixhitale ne zyren perkatese te nje niveli me te larte. Ne keto raste dorezimi behet vetem me urdher te kryeregjistruesit.
10. Arshiva dixhitale qe dorezohet duhet te jete kopje identike e arshives dixhitale te krijuar prane zyres se regjistrimit.

ANEKS 1

DRAFTI I LIGJIT TE PERSHTATUR PER AGJENSINE KOMBETARE TE REGJISTRIMIT TE PASURISE SE PALUAJTSHME (AKRPP) DHE STATUTI I AKRPP

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI POPULLOR**

LIGJI

Nr _____ Date _____ 2001

PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE LIGJIN Nr 7843 DATE 13.07.1994 “PER REGJISTRIMIN E PASURIVE TE PALUAJTSHME”

Ne baze te nenit 100 te Kushtetutes dhe nenit 56 te ligjit 7843 date 13.07.1994 “Per regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme” me propozim te Kryeministrit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I

Neni 1

Shtohet neni 2/1

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ka statusin e Ndermarjes Shteterore

Neni 2

Neni 1 paragrafi i fundit, neni 2, neni 4, neni 6, neni 15, neni 16 dhe neni 57 ndryshohen fjalet nga Zyra te Regjistrimit ne Agjensi te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Neni 3

Neni 3 ndryshohen fjalet nga Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ne Agjensi Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Neni 4

Neni 3 paragrafi i fundit ndryshohet si me poshte:

Drejtori i Pergjithshem i regjistrimit te pasurive te te Paluajtshme te Republikes se Shqiperise organizon dhe drejton Agjensine Kombetare te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme brenda kompetencave qe i jep ligji, Keshilli Administrativ ose qe percaktohen ne Statutin e Agjensise.

Neni 5

Pas nenit 1 ne kreun e dyte “Organizimi i Sistemit te Regjistrimit te Pasurive te Pluajtshme” shtohet neni i ri , neni 2 kryesisht:

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ka keto organe:

- a. Keshilli Drejtues
- b. Drejtori i Pergjithshem

Neni 6

Shtohet neni i ri ne Kreun e XI kryesisht:

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ushtron veprimtarine e tij ekonomike e financiare ne menyre te pavarur. Me te ardhurat qe realizon, ai perballon shpenzimet dhe i paguan shtetit tatimet e taksat e percaktuara ne ligj. Per pjesen tjeter te fitimit vendos Keshilli Drejtues i Agjensise.

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, per te perballuar nevojat e veta, te krijoj e te perdore nga fitimi i tij fondin rezerve ne leke e valute.

Bilanci i Agjensise pasi miratohet nga Keshilli Drejtues i paraqitet Ministrit te Finances.

STATUTI

I

AGJENSISE KOMBETARE EKZEKUTIVE TE REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME

KREU I

KRIJIMI, VENDI DHE KAPITALI THEMELOR

Neni 1

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (A.K.R.P.P) eshte institucion shteteror. Veprimtaria e tij rregullohet sipas ligjit 7843 date 13. 07. 1994 “Per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme” dhe Ligjit “Per ndermarjet shteterore”.

Agjensia Kombetare e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme eshte person juridik shqiptar, qe e ka qendren ne Tirane dhe Agjensi te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme neper rrethe.

